

Presidenti Meta kërkon nga India njohjen e pavarësisë së Kosovës



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**DËSHMORËT
NUK JANË
THJESHT
OBJEKT
PËRKUJTIMI** F. 13



Prof. dr. Kudusi LAMA,
gjeneral në pension

**HASHIM,
JO QË NUK
DO TA KALOSH
RUBIKONIN, POR
DO TË MBYTESH NË
NJË PËRROSKË...
KATUNDI!** F. 11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**MINISTRI HAMZA DHE
KËSHILLTARËT E TIJ
NUK E PRANOJNË PAGËN
ME RRIJJE** F. 7

EKONOMI

**BORXHI
JOPRODUKTIV**

F. 8

Albin KURTI



**GENT BEGOLLI ZGJEDHET
KRYESHEF EKZEKUTIV I
TELEKOMIT TË KOSOVËS** F. 8

SPORT

**BRAZILI FITON ME MUND TË
MADH NDAJ KOSTA RIKËS** F. 18

**GASHI: STADIUMI
NË KAMENICË DO TË
PËRFUNDOJË SIVJET** F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", RIZA SMAKA | FAQE 4-5

Korrigjimi i kufirit me Malin e Zi, i vështirë



Anëtari i Komisionit Shtetëror për Shënjinin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Riza Smaka, ka bërë me dije se korrigjimi i kufirit me Malin e Zi do të jetë shumë i vështirë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka shprehur skepticizëm se pala malazeze do të lejojë një gjë të tillë. Sipas Smakës, Mali i Zi nuk ka pranuar rishikimin e marrëveshjes para ratifikimit dhe njëjtë do të veprojë tash edhe pas ratifikimit të marrëveshjes. Smaka ka treguar se pala e Kosovës në takim me atë malazeze do ta kërkojë vetëm korrigjimin e vijës kufitare sipas raportit të Komisionit të ri Shtetëror dhe në këtë drejtim pret reflektim nga Mali i Zi. Ai ka treguar se tani pritet që Qeveria e Kosovës ta formojë grupin e përbashkët me Malin e Zi për rishikimin e marrëveshjes

Delawie: Kosova ka të ardhme evropiane vetëm nëse gjykatat janë të pakorruptuara

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Greg Delawie, ka shprehur të premtën

shqetësimin për ndikimin politik të ushtruar në gjykata, në të gjitha nivelet, duke thënë se Kosova ka të



ardhme evropiane vetëm nëse gjykatat janë të pavarura, të pakorruptuara dhe zbatojnë ligjet e Kushtetutën | FAQE 7

Gërxfhaliu: Partitë politike t'i ndalin punësimet e militantëve në institucione



Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxfhaliu, ka thënë se është shqetësues punësimi i vazhdueshëm i militantëve partiakë në institucionet e shtetit dhe në ndërmarrjet publike. Nëpërmjet gazetës "Epoka e re" ai ka bërë thirrje të ndalet kjo praktikë e punësimeve partiake

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Cureç-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Pritren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pacolli: Zvicra do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka takuar ministrin e Punëve të Jashtme të Konfederatës Zvicerane, Ignazio Cassis, ku kanë diskutuar për marrëdhëniet bilaterale, në interes të të dyja vendeve dhe në funksion të kultivimit të mëtejshëm të

bashkëpunimit me shtetin zviceran. "Sot, në kuadër të turneut tim, për ta fuqizuar politikën e jashtme të Kosovës, kisha nderin të takohem me ministrin e Punëve të Jashtme të Konfederatës Zvicerane, dr. Ignazio Cassis. Me ministrin Cassis zhvilluam një bisedë të gjatë ku trajtuam tema aktuale

që lidhen me marrëdhëniet tona bilaterale, në interes të vendeve tona dhe në funksion të kultivimit të mëtejshëm të bashkëpunimit me shtetin zviceran. Zvicra si gjithmonë do të vazhdojë të mbështetë Kosovën në të gjitha drejtimit, qofshin ato të karakterit ekonomik apo politik", ka shkruar Pacolli në "Facebook".



Holanda voton kundër nisjes së negociatave me Shqipërinë

TIRANË, 22 QERSHOR - Komplikohet çështja e statusit për në BE e Shqipërisë, pas votimit të Parlamentit të Holandës kundër Shqipërisë. Parlamenti i Holandës ka votuar për mosdhënien e dritës jeshile për nisjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Sipas shumicës dërmuese të deputetëve holandezë, "rezultatet e Shqipërisë janë të pamjaftueshme për të ndërmarrë një hap të tillë".

Edhe kryetari i PD-së, Lulzim Basha, foli të premten në Kuvendin e Shqipërisë se ka shtete të cilat kanë rezerva të mëdha për kryeministrin Rama, ndaj Shqipëria do ta humbasë shansin edhe këtë radhë. Parlamenti holandez i kërkon Qeverisë të mos shprehet në favor të propozimit të Komisionit

Evropian për Shqipërinë, pasi thotë se ky vend nuk ka plotësuar pesë kushtet e vendosura nga Brukseli, ndërsa theksin e vendos te lufta ndaj korrupsionit dhe krimit. "Duke vënë në dukje se Shqipëria në mënyrë të qartë nuk i përmbush pesë kushtet e përcaktuara në bazë të këtij raporti të progresit, sepse nuk ka histori në reformën ligjore, në luftën kundër korrupsionit dhe në luftën kundër krimit. Vëren se në bazë të këtij progres-raporti nuk mund të hapen negociatat për praninë. Qeveria holandeze nuk duhet të votojë në favor të propozimit të KE-së për hapjen e negociatave", thuhet në mocionin e miratuar në Dhomën e Përfaqësuesve të Holandës, të hartuar nga Van Helvert, Omtzigt, Anne Mulder, Van der Graaf. Më herët ishte gazeta holandeze



"De Telegraaf" që njoftoi se Holanda ka vendosur ta bllokojë hapjen e negociatave dhe ky është mesazhi që shumica e dhomës së përfaqësuesve do t'i dërgojë përmes Qeverisë në samitin e radhës të ministrave të jashtëm të BE-së. Deputetët e partive VVD, CDA,

CU, PVV, SP dhe 50Plus kishin deklaruar se do të votonin kundër hapjes së negociatave të BE-së me Shqipërinë tonë dhe Maqedoninë, me argumentin se ende nuk është bërë sa duhet në luftën kundër korrupsionit e krimit të organizuar. "Kemi një shqetësim serioz për luftën

kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri", ka deklaruar ministri i Jashtëm, Stephanus Abraham Blok. Gazeta thotë se përse gjashtë parti parlamentare bashkuan votat për ta ndaluar Qeverinë që të pranojë hapjen e negociatave me Shqipërinë.

Sipas deputetëve skeptikë, ka progres në Shqipëri, por ecuria e dobët e procesit të vetingut nuk është bindëse për hapjen e negociatave. Holanda ishte një nga tre vendet skeptike përhapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Flitet se edhe Franca ka rezerva për statusin. Ndërkohë, pas datës 28 qershor priten valë të mëdha protestash të opozitës shqiptare për të rrëzuar kryeministrin Rama.

Mitchell: ShBA-ja bashkëpunon me BE-në rreth Kosovës e Serbisë



BRUKSEL, 22 QERSHOR - Ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit për çështje të Evropës dhe Euroazisë, Wess Mitchell, tha se Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian e kanë synim të përbashkët reformimin e Ballkanit në rrugën drejt BE-së. Mitchell, në një fjalim në Institutin Carnegie Europe në

Bruksel, tha se pavarësisht prej disa dallimeve midis ShBA-së dhe BE-së, ka shumë çështje që i bashkojnë aleatët. "Amerika dhe Evropa kanë interes të përbashkët që bota të jetë e lirë, që Rusia të përgjigjet për aneksimin e Krimesë, që ta ndalojë përdorimin e armëve kimike dhe që të ndërpriten politikatat e padrejta tregtare të Kinës", tha

Mitchell, transmeton Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë".

Mitchell, po ashtu, theksoi se Shtetet e Bashkuara bashkëpunojnë me Bashkimin Evropian rreth Kosovës dhe Serbisë. Dy vendet janë në bisedime për normalizimin e marrëdhënieve, me ndërmjetësimin e BE-së.

Marrëveshja e detit, Bushati - Kotzias takohen sërish

TIRANË, 22 QERSHOR - Burime diplomatike greke njoftojnë se mes ministrin Ditmir Bushati dhe homologut të tij grek Nikos Kotzias janë zhvilluar dy takime në ishullin e Rodosit. Ministri i Jashtëm shqiptar ka deklaruar para hyrjes në Konferencën e tretë për

Sigurinë dhe Stabilitetin, se është bërë progres thelbësor në shumë çështje që nga takimet e fundit.

Por megjithëse janë zhvilluar brenda 24 orëve dy takime kokë më kokë, mes dy kryediplomatëve nuk dihet ende nëse marrëveshja mund të kon-

siderohet e përfunduar. Takimi i parë ka zgjatur më shumë se një orë dhe është zhvilluar të enjten në mbrëmje, kurse i dyti gjatë punimeve të konferencës. Burime diplomatike greke kanë hedhur poshtë publikimet e ndryshme në mediet e dy vendeve për përfshirjen apo jo

të çështjes çame në tryezë, duke i konsideruar të qëllimshme dhe si një pengesë për mbylljen përfundimtare të paketës së çështjeve me Shqipërinë. Por, ato theksojnë se ka vendosmëri nga të dyja palët që shumë shpejt të vijë nënshkrimi i marrëveshjes që



do t'u japë fund konflikteve dypalëshe, të trashëguara prej dhjetëra vjetësh.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Kosova përfiton 48 milionë euro nga IPA 2017

Qeveria e Kosovës të premtën ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare IPA 2017 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian e cila mundëson shfrytëzimin e fondeve financiare në vlerë prej 48 milionë eurosh. Këto mjete do të shfrytëzohen për 11 projekte të ndryshme të ndërtimit të kapaciteteve qeverisëse në Kosovë. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar edhe vendimin për hapjen e zonës ekonomike në Rahovec



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Kabineti qeveritar të premtën ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare IPA 2017 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian (BE) e cila hap rrugën për shfrytëzimin e fondeve financiare në vlerë 49 milionë e 450 mijë euro nga të cilat 48 milionë do të financohen nga BE-ja, kurse 1 milion e 450 mijë euro do të financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës për vitet 2018-2021.

Shfrytëzimi i këtyre fondeve do të bëhet për 11 projekte të ndryshme të ndërtimit të kapaciteteve qeverisëse në Republikën e Kosovës. Qeveria ka aprovuar edhe propozimet për të kërkuar nga presidenti i Kosovës dhënien e autorizimit ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Financimit "Projekti i ekonomisë digjitale të Kosovës" me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim si dhe dhënien e autorizimit ministres së Integritimit Evropian për plotësim-ndryshimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Miratimin e kabinetit qeveritar e

ka marrë edhe Projektligji për Inspektoratin e Punës, i cili u jep autorizim inspektorëve të punës që ta bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit ndaj personave fizikë dhe juridikë, vendës dhe të huaj, privatë dhe publikë që ushtrojnë veprimtari fitimprurëse apo jofitimprurëse në territorin e Republikës së Kosovës.

Qeveria ka aprovuar edhe propozimin për themelimin e Këshillit të Turizmit të Kosovës dhe Komitetit Shtetëror për Shëndetin Mjedisor. Po në këtë mbledhje është miratuar kërkesa e Britanisë së Madhe për vazhdimësinë e aplikimit të MSA-së edhe gjatë periudhës transitorë të daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja. Gjithashtu, në mbledhjen e së premtës është përkrahur edhe kërkesa e Komunitetit të Rahovecit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme "Pasuri Shtetërore e Kosovës, K. K. Rahovec", që shfrytëzohet nga Ekonomia Pyjore dhe menaxhohet nga Agjencia Pyjore e Kosovës. Kjo pronë është dhënë në shfrytëzim me qëllim të krijimit të Zonës Ekonomike, me ç'rast Komuna e Rahovecit obligohet t'i zhvillojë të gjitha procedurat dhe t'i përmbushë detyrimet sipas legjislacionit në

fuqi.

Qeveria ka mbështetur edhe kërkesën e Komunitetit të Leposaviqit për çështjen e 211 punonjësve të komunës, të cilët kanë qenë në listën e pagave dhe të cilët janë financiar nga buxheti i veçantë i Qeverisë, para nënshkrimit të marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013. Me këtë vendim obligohet Ministria e Financave që në bashkëpunim me Komunitetin e Leposaviqit të ndërmarrin veprimet sipas legjislacionit në fuqi lidhur me largimin e punëtorëve që figurojnë me vlerë zero në listën e pagave, në të gjitha programet ekonomike si dhe t'i ndërmarrin veprimet ligjore lidhur me lejimin e numrit të punonjësve sipas buxhetit të komunës të destinuar për këtë qëllim.

Kabineti qeveritar ka aprovuar

edhe vendimin përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të cilat preken nga ndërtimi i autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, zona kadastrale Nikaj dhe Soponicë, komuna e Kaçanikut dhe zona kadastrale Hani i Elezit, komuna Hani i Elezit.

Gjithashtu, Qeveria ka miratuar edhe vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimeve përfundimtare për shpronësim të datës 3 gusht 2011 dhe 25 prill 2012. Me ndryshimin dhe plotësimin e vendimeve korrigjohet sipërfaqja e shpronësuar të cilat preken nga ndërtimi i rrugës nacionale Prishtinë - Mitrovicë, sipas gjendjes së re faktike që është vërtetuar nga Ministria e Infrastrukturës për ndërtimin e nënkallimit në zonën kadastrale në Mazgit.

Edhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka marrë mbështetjen e Qeverisë së Kosovës për fillimin e procedurave për aplikimin e Kosovës për statusin e anëtarit vëzhgues në Organizatën Botërore të Tregtisë. Në këtë mbledhje Qeveria ka aprovuar edhe vendimin për vazhdimin e mandatit të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Lulzim Ejupi. Ndërsa ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, e ka informuar kabinetin qeveritar për të gjeturat e Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën dhe Programin Kombëtar për zbatim të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit. Ajo ka bërë me dije se të gjeturat do t'u adresohen të gjitha ministrive përgjegjëse.

Më 5 korrik mbahet interpelanca për 53 milionëshin e 'Bechtel Enka'-s

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Kryesia e Kuvendit të Kosovës, së bashku me shefat e grupeve parlamentare, ka përcaktuar agjendën e punës së Kuvendit për dy javët e ardhshme. Kryesia ka vendosur që të enjten, më 28 qershor, në orën 10:00, Kuvendi të mbledhet në seancë të jashtëzakonshme, në të cilën pritet ta shqyrtojë në të dy leximet Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ndërsa në orën 12:00, në të njëjtën ditë, do të vazhdojnë



punimet e seancës plenare me pikat e papërfunduara më 6, 8

dhe 14 qershor 2018, përkatësisht votimet për propozim-

rezolutat për tri interpelanca të kryeministrit Ramush Haradinaj: në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës, në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës, si dhe atë për vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikallo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione. Ndërkaq më 5 korrik, në orën

10:00, Kuvendi do të mbledhet në seancë të re.

Pas pyetjeve parlamentare dhe deklarimeve jashtë rendit të ditës, do të mbahet interpelancë e kryeministrit Ramush Haradinaj në lidhje me pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë "Bechtel Enka" në kontratën për ndërtimin e Autostradës R6, Prishtinë - Hani i Elezit. Në këtë seancë do të shqyrtohet në parim Projektligji për efikasitet të energjisë, ndërsa në lexim të dytë Projektligji për shërbimet postare dhe ai për masat mbrojtëse në importe.

Flet për "Epokën e re", Riza Smaka

Korrigjimi i kufirit me



Anëtari i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Riza Smaka, ka bërë me dije se korrigjimi i kufirit me Malin e Zi do të jetë shumë i vështirë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka shprehur skepticizëm se pala malazeze do të lejojë një gjë të tillë. Sipas Smakës, Mali i Zi nuk ka pranuar rishikimin e marrëveshjes para ratifikimit dhe njëjtë do të veprojë tash edhe pas ratifikimit të marrëveshjes. Smaka ka treguar se pala e Kosovës në takim me atë malazeze do ta kërkojë vetëm korrigjimin e vijës kufitare sipas raportit të Komisionit të ri Shtetëror dhe në këtë drejtim pret reflektim nga Mali i Zi. Ai ka treguar se tani pritët që Qeveria e Kosovës ta formojë grupin e përbashkët me Malin e Zi për rishikimin e marrëveshjes

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Anëtari i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Riza Smaka, ka shprehur skepticizëm se mund të ndodhë korrigjimi i kufirit me Malin e Zi. Ai ka bërë me dije se korrigjimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi do të jetë shumë i vështirë ngaqë pala malazeze i ka të gjitha argumentet për të mos lejuar një gjë të tillë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Smaka ka

vlerësuar se Mali i Zi për shkak të fqinjësisë së mirë do të duhej t'i pranojë gabimet që janë bërë në këtë proces. "Absolutisht se do të jetë i vështirë, sepse pala malazeze nuk e ka pranuar rishikimin e kësaj marrëveshje as para ratifikimit, e lëre tash pas ratifikimit. Tani pala malazeze e ka marrëveshjen që është miratuar nga ish-komisioni i Kosovës dhe ai i Malit të Zi, nga të dy qeveritë dhe nga kuvendet e të dy shteteve. Po ashtu, janë këmbyer edhe letrat e ratifikimit dhe janë shpallur në gazetën zyrtare. Kështu që, vështirë të pritët se mund të

ndodhë ndonjë rishikim i marrëveshjes. Natyrisht se për hir të fqinjësisë së mirë në mes të dy shteteve do të duhej që pala malazeze të reflektojë në këtë drejtim", ka thënë Smaka. Ai ka deklaruar se deri më tani Qeveria e Kosovës është dashur të lëvizë në drejtim të korrigjimit të kësaj marrëveshje, duke caktuar grupin e përbashkët me palën malazeze, i cili parashihet në marrëveshje. Smaka ka treguar se në tryezë me palën malazeze do të jenë parimorë dhe do ta kërkojnë rishikimin e kufirit në bazë të raportit që ka hartuar komi-

sioni shtetëror. "Kërkesa jonë do të jetë konsekuente dhe konsistente në kufirin që ka ekzistuar prej vitit 1945-1946. Pra, do të kërkojmë mirëkuptim nga pala malazeze që ta rishikojmë kufirin. Dhe, në qoftë se nuk e pranon këtë kërkesë pala malazeze, unë besoj se pala jonë do të duhej të tërhiqej", ka thënë Smaka, duke shprehur shqetësimin e tij se pala malazeze nuk do ta pranojë korrigjimin. "Frikësohem se pala malazeze do të refuzonte, sepse pala malazeze e ka arritur synimin e vet, ka marrë mbi 8 000 hektarë tokë. Prandaj, kemi qëndrim parimor në këtë çështje dhe në takim nuk do të shkojmë me shënimin e kufirit që ka bërë ish-komisioni", është shprehur Smaka.

"Epoka e re": Z. Smaka, janë bërë tre muaj nga miratimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. Në Ligjin e marrëveshjes është përfshirë edhe raporti i Komisionit të ri

Shtetëror, i cilin tregon për gabimet që janë bërë në këtë proces. Ka filluar komisioni të marrë ndonjë veprim në drejtim të korrigjimit të marrëveshjes?

Smaka: Kuvendi i Kosovës ka gabuar rëndë kur ka ratifikuar marrëveshjen për kufirin. Komisioni aktual shtetëror pati hartuar një raport prej 700 faqesh me plot argumente, se ajo marrëveshje nuk është dashur të ratifikohet. Në këtë rast, Kuvendi jo që ka ratifikuar një marrëveshje të gabuar, mirëpo opinionin e ka vënë në lajthim, sepse marrëveshja e ratifikuar nuk është marrëveshje për demarkacion, por marrëveshje për ridemilitacion. Pra, demarkacioni duhet të bëhet brenda dy vjetësh prej momentit të ratifikimit. Komisioni Shtetëror për Mirëmbajtjen e Kufirit është duke punuar, por ne nuk mund të punojmë më shumë sesa na diktojnë faktet. Raporti i komisionit që ka hyrë në marrëveshje nuk ka kurrfarë domethënie për palën

Malin e Zi, i vështirë



"Epoka e re": Në bazë të kësaj që po thoni, i bie se rishikimi i mundshëm i kësaj marrëveshje do të jetë shumë i vështirë?

Smaka: Absolutisht se do të jetë i vështirë, sepse pala malazeze nuk e ka pranuar rishikimin e kësaj marrëveshje as para ratifikimit, e lëre tash pas ratifikimit. Tani pala malazeze e ka marrëveshjen që është miratuar nga ish-komisioni i Kosovës dhe ai i Malit të Zi, nga të dy qeveritë dhe nga kuvendet e të dy shteteve. Po ashtu, janë këmbyer edhe letrat e ratifikimit dhe janë shpallur në gazetën zyrtare. Kështu që, vështirë të pritet se mund të ndodhë ndonjë rishikim i marrëveshjes. Natyrisht se për hir të fqinjësisë së mirë në mes të dy shteteve, do të duhej që pala malazeze të reflektojë në këtë drejtim, sepse kufiri është i qëndrueshëm nëse është i pranueshëm nga të dyja palët.

"Epoka e re": Tani është për-

mendur se në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi do të ndodhë edhe demarkacioni në mes të dy shteteve. Sa do të jetë i vështirë ky proces kur kihen parasysh raportet në mes të dy shteteve?

Smaka: Me Serbinë vështirë ishte, është dhe do të jetë. Mirëpo qëndrimi ynë do të jetë i pandryshueshëm që linja administrative e cila ekziston prej vitit 1945-1946 do të jetë linjë për demarkim. Pra, ne nuk do të hyjmë në ridemilitacion, sepse demilitacioni është caktimi i kufirit. Ne do të insistojmë caktim të demarkacionit sipas kufirit të caktuar në vitin 1945-1946. Ne do të jemi konsistentë dhe pala serbe do ta ketë shumë vështirë me neve. Natyrisht se këtë qëndrim do të duhej ta kishte edhe ish-komisioni shtetëror.

"Epoka e re": Pra, besoni se Kosova dhe komisioni aktual janë të përgatitur profesionalisht

për këtë proces?

Smaka: Patjetër se po. Ne jemi të përgatitur profesionalisht dhe teknikisht. Komisioni Badinterit i vitit 1991 e pati sanksionuar ndarjen administrative si ndarje e kufijve politikë. Pra, ata kufij administrativë kanë shërbyer për demarkacion për të gjitha vendet e dala nga ish-Jugosllavia. Në këtë drejtim, ne e kemi edhe aspektin juridik ndërkombëtar në favorin tonë.

"Epoka e re": Do të jetë e nevojshme ndihma e NATO-s dhe e partnerëve të Kosovës në përcaktimin e kësaj vije kufitare?

Smaka: Në aspektin politik patjetër se do të jetë e nevojshme ndihma e ndërkombëtareve, sepse pa ndihmën e tyre as që do të hapej çështja e demarkacionit me Serbinë, kurse në aspektin profesional nuk besoj se do të ketë nevojë. Ani pse ndihma do të ishte tepër e mirëseardhur, ne jemi kompetentë për ta bërë këtë punë.

Presidenti Meta kërkon nga India njohjen e pavarësisë së Kosovës

TIRANË, 22 QERSHOR (ER) - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka pranuar të premtën letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Indisë, Thanglura Darlong, me rezidencë në Bukuresht. Presidenti Meta ka vlerësuar marrëdhëniet miqësore e të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Indisë, si dhe lidhjen e fortë që Nënë Tereza

krijoi midis dy vendeve. Në mënyrë të veçantë, presidenti Meta ka vlerësuar nevojën e rritjes së bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, si dhe të kontakteve të drejtpërdrejta mes sipërmarrësve dhe qytetarëve të të dy vendeve. "Gjetja e mekanizmave praktike për lehtësimin e regjimit të vizave dhe lëvizjes së sipërmarrësve dhe qytetarëve të të dy vendeve

do të ndihmonte shumë në këtë drejtim", ka theksuar presidenti Meta. Ndërsa duke iu referuar zhvillimeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, presidenti Meta ka nënvizuar se një rishikim i pozicionit të Indisë ndaj njohjes së pavarësisë së Kosovës do të ishte një kontribut i drejtpërdrejtë për forcimin e paqes dhe stabilitetit në këtë rajon.



malazeze, sepse marrëveshja duhet të jetë reciprokisht e njëjtë, pikë për pikë dhe presje për presje. Vetëm një marrëveshje e tillë i obligon palët.

"Epoka e re": Në ligj ka hyrë edhe deklarata e përbashkët e dy presidentëve për korrigjim të kufirit, ku pala malazeze shpreh vullnetin për korrigjimin e marrëveshjes. Nuk do të ketë ndonjë ndikim kjo?

Smaka: Ajo është një deklaratë që nuk e obligon askënd. Pra, ajo është një deklaratë konform me standardet e demarkacionit, që kur të bëhet demarkacioni, të bëhen edhe korrigjimet tokësore dypalëshe. Pra, nëse tre hektarë i marrim nga Mali i Zi, duhet që tre hektarë t'ua japim palës malazeze. Kështu që, ajo deklaratë nuk ka ndonjë vlerë.

"Epoka e re": Deri më tani Qeveria e Kosovës a është dashur të ndërmarrë ndonjë hap drejt korrigjimit?

Smaka: Natyrisht se është dashur të bëhet diçka në këtë

drejtim. Tash pritet që Qeveria ta formojë grupin e përbashkët me palën malazeze në mënyrë që pastaj të ulemi edhe një herë në tryezë për ta shqyrtuar këtë çështje.

"Epoka e re": Cilat do të jenë kërkesat e komisionit me rastin e takimit që do ta keni me palën malazeze?

Smaka: Kërkesa jonë do të jetë konsekuente dhe konsistence në kufirin që ka ekzistuar prej vitit 1945-1946. Pra, do të kërkojmë mirëkuptim nga pala malazeze që ta rishikojmë kufirin. Dhe në qoftë se nuk e pranon këtë kërkesë pala malazeze, unë besoj se pala jonë do të duhej të tërhiqej. Frikësohem se pala malazeze do të refuzonte, sepse pala malazeze ka arritur synimin e vet, ka marrë mbi 8 000 hektarë tokë. Prandaj, ne kemi qëndrim parimor në këtë çështje dhe në takim nuk do të shkojmë me shënimin e kufirit që ka bërë ish-komisioni.

Haradinaj: Investimi në energji alternative është punë e dobishme për Kosovën

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të premtën në përrurimin e fluturakeve të para të prodhimit të rrymës me erë të cilat po bëhen nga kompania "Air Energy". Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se arsyeja e vizitës është për t'u njohur më për së afërmi me përparimet që kanë ndodhur në investimet në energjinë me erë. "Investimi në energji alternative është punë e dobishme për Kosovën", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke u shprehur i bindur se institucionet e Kosovës do të jenë partnere korrekte për investitorët. Haradinaj duke falënderuar kompaninë "Air Energy", e cila ka sjellë një

teknologji shumë të re dhe të avancuar dhe e cila ka zgjedhur Kosovën për të investuar, tha se bëhet fjalë për një projekt të suksesshëm.

Përfaqësuesi nga Turqia i kompanisë "Air Energy", Musfik Hamdi Yamanturk, ka thënë se kjo kompani ekziston që 61 vjet dhe projekti këtu është ndër projektet e para jashtë Turqisë dhe një tjetër që është në Ukrainë. "Shpresojmë shumë edhe në investime të tjera të kësaj natyre", është shprehur Yamanturk. Ndërkaq Sait Vokshi, bashkinvestitor në këtë projekt, u shpreh i kënaqur me punën që është bërë, duke shpresuar se edhe në shumë projekte të tjera do ta kenë përkrahjen e Qeverisë së Kosovës.



Në Kaçanik lansohet projekti i vizitave për nëna dhe fëmijë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

KAÇANIK, 22 QERSHOR - Kaçaniku të premtën është bërë komuna e 13 në Kosovë, ku edhe zyrtarisht është lansuar projekti i vizitave për nëna dhe fëmijë deri në moshën tre vjeç. Projekti i nisur nga Ministria e Shëndetësisë, i mbështetur nga UNICEF-i dhe komunat, i cili kishte nisur fillimisht në vetëm dy komuna, tani është shtrirë në 13 të tilla, me qëllim që brenda një periudhe të shkurtër të shtrihet në gjithë vendin. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lansimin e këtij projekti edhe në Komunën e Kaçanikut, ka thënë se ky është një ndër programet që ka ndikim te qytetarët dhe që rrit besimin e qytetarëve në sistemin shëndetësor. "Këto programe ndikojnë në dy aspekte. Përveç ndikimit pozitiv në aspektin shëndetësor, ato kthejnë dhe rrisin besimin e qytetarëve në shërbimet tona shëndetësore dhe personelin



mjekësor. Duke parë rëndësinë e tyre, ne do të punojmë që këto vizita të shtrihen edhe nëpër komunat e tjera", ka thënë ministri Ismaili.

Më tej, ai ka shtuar se mbështetja e tij edhe për Kaçanikun nuk do të mungojë sa iu përket projekteve të tjera.

Zëvendëshefi i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, James Mugaju, ka deklaruar se UNICEF-i do të vazhdojë të mbështesë programe të tilla, të cilat rrisin besimin e qytetarëve në shërbimet shëndetësore. Kurse kryetari i Kaçanikut, Besim Ilazi, falënderoi

ministrin Ismaili për përkushtimin e tij që ky program të shtrihet edhe në Kaçanik. Projekti i vizitave për nëna dhe fëmijë, i cili deri sot ka qenë aktiv në 12 komuna, ka zhvilluar mijëra vizita vetëm gjatë vitit 2018. Në vitin 2018, ky program është shtrirë në tri komuna të

tjera, Dardanë, Shtime, Viti dhe në Kaçanik. Përmes këtij programi është mundësuar qasje për të gjithë në shërbimet shëndetësore dhe është përmirësuar cilësia e shërbimeve. Po ashtu, mbrojtja sociale është një nga shtyllat e ngritura të këtij projekti.

Qeveria për tre muaj shpenzoi 408.5 milionë euro

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare të Kosovës në bazë tremujore. Ky botim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe (TM1 2018). Shuma e përgjithshme e të hyrave të Qeverisë për

TM12018 ishte 408.5 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, të cilat paraqesin 63 % të totalit të të hyrave, ndërsa pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave.

Në TM1 2018 totali i përgjithshëm i shpenzimeve

të Qeverisë ishte 413.5 milionë euro. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë kompensimi i punëtorëve (35 %), kontributet sociale dhe përfitimet (27 %), formimi i kapitalit bruto (18 %) dhe konsumi i ndërmjetëm (10 %). Pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në struktura të tjera të shpenzimeve.



Delawie: Kosova ka të ardhme evropiane vetëm nëse gjykatat janë të pakorruptuara

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Greg Delawie, ka shprehur të premten shqetësimin e tij për ndikimin politik të ushtruar në gjykata, në të gjitha nivelet, duke thënë se Kosova ka të ardhme evropiane vetëm nëse gjykatat janë të pavarura, të pakorruptuara dhe zbatojnë ligjet e kushtetutën

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Në kuadër të "Javës Kundër Korrupsionit" të mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, koalicioni i organizatave joqeveritare (OJQ) "Java Kundër Korrupsionit 2017" të premten ka mbajtur konferencë për media, për të shpalosur ndikimet e raportimeve të rasteve të raportuara në kuadër të "Javës Kundër Korrupsionit" të mbajtur në dhjetor 2017.

Në këtë konferencë përfaqësuesit e koalicionit të OJQ-ve "Java Kundër Korrupsionit 2017" publikuan raportin përmbledhës për raportimet dhe ndikimin e raportimeve të OJQ-ve të koalicionit "Java Kundër Korrupsionit 2017". Pjesë e konferencës së përbashkët të koalicionit të OJQ-ve "Java Kundër Korrupsionit 2017" ishte edhe ambasadori amerikan Greg Delawie, i cili vlerësoi ndjekjen e zhvillimeve për çështjet e ngritura në dhjetor të vitit të kaluar, duke thënë se është mënyra më e mirë për të bërë ndryshime, pasi progresi është i pamundur pa këmbëngulje. "Jo çdo gjë për të cilën

është debatuar dhe theksuar gjatë dhjetorit të kaluar është zgjidhur. Puna vazhdon. Duhet të vazhdojë. Shumë sfida mbesin ende përpara", ka thënë Delawie.

Gjatë kësaj konference ambasadori Delawie ka shprehur shqetësimin e tij për ndikimin politik të ushtruar në gjykata, në të gjitha nivelet, duke thënë se Kosova ka të ardhme evropiane vetëm nëse gjykatat janë të pavarura, të pakorruptuara dhe zbatojnë ligjet e kushtetutën. Ai ka theksuar se mbështetja e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë në luftën kundër korrupsionit do të vazhdojë edhe më tutje. "Ashtu siç Ambasada ime ju ka mbështetur në të kaluarën, do të vazhdojmë t'ju mbështesim edhe në të ardhmen. Luftimi i korrupsionit ka qenë prioriteti im më i lartë që kam ardhur në Kosovë tre vjet më parë. Ne do të vazhdojmë t'i japim burimet tona, ekspertizën tonë dhe mbështetjen tonë morale për ata që, si unë, e shohin se lufta kundër korrupsionit në Kosovë është kritike për suksesin e ardhshëm të këtij vendi", ka thënë Delawie. Pas fjalimit të ambasadorit amerikan, përfaqësuesit e koalicionit të OJQ-ve "Java Kundër Korrupsionit 2017" kanë prezantuar ndikimet e raportimeve të tyre. Drejtoresha ekzekutive e Institutit GAP, Nora Latifi, ka bërë me dije se pas publikimit të analizës mbi monopolin e homologimit të automjeteve është bërë një arritje e rëndësishme drejt thyerjes së monopolit, e që mund të konsiderohet një sukses i Institutit GAP. Ndërsa sa i përket çështjes së faljes së borxheve publike për kompanitë e shisheve të ujit, Latifi ka pohuar se pas reagimit publik të Institutit GAP, GLPS dhe INDEP, Qeveria e Kosovës (me vendimin e saj të marrë më 28 shkurt 2018) e revokoi vendimin e 3 tetorit 2017 me të cilin i fali borxhet dhe obligimet



që prodhuesit e shisheve të ujit i kishin borxh buxhetit të Republikës së Kosovës që nga viti 2008. Lekë Batalli nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka deklaruar se publikimi i raportit për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AKA) ka shkaktuar debat dhe ka ngritur vëmendjen mbi këtë rast. Kurse drejtoresha ekzekutive e INPO-s, Albulena Nrecaj, ka thënë se edhe pas publikimit të dy raporteve të cilat kanë trajtuar rastet e keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të parasë publike nga Komuna e Ferizajt, Mitrovicës dhe Prizrenit përmes procedurave të prokurimit publik, institucionet e drejtësisë nuk

kanë ndërmarrë asnjë veprim për t'i hetuar zyrtarët që kanë kryer këto veprime. Drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Betim Musliu, ka shpalosur ndikimet e raportimeve të katër rasteve në "Javën Kundër Korrupsionit 2017". Lidhur me publikimin e raportit për aferën e njohur "Pronto", Musliu ka thënë se ende nuk kanë marrë përgjigje për pyetjet e shtruara. Megjithatë, sipas tij, ndikim në këtë rast mund të konsiderohet fakti që presioni i madh publik ka shtyrë prokurorinë të bëjë një hetim dhe të ngrehë një aktakuzë, për të cilën IKD-ja konsideron se është aktakuzë selektive për shkak se ka amnisuar protagonistët kryesorë.

Ministri Hamza dhe këshilltarët e tij nuk e pranojnë pagën me rritje



PRISHTINË, 22 QERSHOR - Ministri i Financave, Bedri Hamza, bashkë me këshilltarët e tij, ka vendosur të mos e marrë pagën me rritje, edhe pse Gjykata Kushtetuese konstatoi se vendimi i ekzekutivit për rritjen e pagave nuk bie ndesh me dokumentin themeltar. Hamza është ministri i parë që po del kundër këtij vendimi të Qeverisë Haradinaj. Ai konsideron se një rritje e tillë është e dëmshme për buxhetin e Kosovës e, siç shpjegon këshilltari i tij, Lulzim Rafuna, i ka dërguar një kërkesë Departamenti të Thesarit që të paktën paga e tij të mos rritet, duke u qëndruar besnik parimeve të përvjuara edhe më

parë.

Në 100-ditëshin e parë të qeverisjes së tij, Haradinaj mori vendimin e rritjes së pagave në 23 nivele të ndryshme zyrtare, duke filluar nga ai vetë e deri te përgjegjësitë për publikun në Qeveri. Një lëvizje e tillë u kritikua ashpër nga opozita dhe shoqëria civile. Vendimin në fjalë Vetëvendosja e kishte dërguar në Gjykatën Kushtetuese, e cila javën e kaluar konstatoi se nuk kishte shkelje. Vetë kryeministri Haradinaj ka reaguar duke thënë se kreu i Ministrisë së Financave nuk po tregon burrëri me këtë gest. Ai ka shtuar se shumë shpejt do të ketë një ligj të mirëfilltë për pagat, duke realizuar kështu nivelimin e tyre.

Borxhi joproduktiv



Albin KURTI

Borxhi shtetëror i Republikës së Kosovës në vitin 2018 tejkaloi shifrën prej 1 miliard eurove. Dikujt mund t'i duket pak por, kur merret parasysh që kjo shifër është arritur në më pak se një dekadë, atëherë trendi merr formë të frikshme dhe një shteti të tillë nuk mund t'i përshkruhet e ardhme e mirë fiskale.

Borxhi i jashtëm i Kosovës është 416 milionë euro, prej tyre 75 % i kemi ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe

Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZh), të dyja marrin pjesë me nga 160 milionë euro.

Paratë e së parës (FMN) kanë shkuar në paga dhe asfalt dhe ato duhet të kthehen brenda pesë vjetëve, kurse paratë e së dytës (BNRZh) nuk i kemi parë kurrë, sepse ato janë në fakt borxh i trashëguar nga ish-Jugosllavia, që në fillim ishte 381 milionë euro, por që tani ka rënë sepse një pjesë është shlyer.

Borxhi i brendshëm, nga ana tjetër, është 613 milionë euro, dhe vjen prej emetimit të Letrave me Vlerë, para këto që gjithashtu kanë shkuar për asfalt dhe paga, sepse nuk kanë pasur ndonjë dedikim të caktuar.

Dikush mund të pyesë se ku kanë shkuar gjithë këto mjete financiare dhe ku qëndron efekti ekonomik e shoqëror i këtyre

mjeteve?

Sikurse që mund të pyesë se si u bë që në vend se të marrim pjesë në ndarjen e pasurisë së ish Jugosllavisë, ne marrim pjesë vetëm në borxhin e saj?

Apo, si u bë që duhet t'ia paguajmë Serbisë borxhet, ndërkohë që ajo përveç se ka grabitur fondin pensional dhe depozitat bankare të Kosovës, ende na ka borxh për dëmet e luftës dhe okupimit?

Nëse e shikojmë borxhin shtetëror të Republikës së Kosovës, kreditë që janë marrë dhe projektet për të cilat janë përcaktuar ato mjete financiare, atëherë shohim se si shumta të vogla dhe mesatare janë ndarë për ujësjellës, ujëra të zeza, infrastrukturë shkollore e spitale, ndërsa shumta e mëdha për investime në infrastrukturë rrugore e autostrada që lehtëso-

jnë qarkullimin e kapitalit të huaj në vend, për ta lënë një pjesë që sërish futet në qarkullim si pagesë ndaj borxhit të marrë për këto projekte.

Pra, rritja e borxhit shtetëror të Republikës së Kosovës nuk është se ka shkuar në investime që e rrisin ekonominë vendore.

Në vend të kësaj, borxhi ka shkuar në ngritje të pagave në sektorin publik dhe në asfalt, duke u shoqëruar me mungesë transparence në këto projekte e me aferra korruptive që kanë përcjellë shpenzimin e këtyre parave.

E kulmi i gjithë kësaj është transparent: tendenca e shlyerjes së borxhit me borxh, çfarë po shkon duke e rritur në vazhdimësi borxhin.

Kjo lehtësi e shtimit të borxhit shtetëror, përcjellë me aferra korruptive, dhe sidomos mungesa e

vizionit të qeveritarëve kosovarë, e kanë lënë ekonominë në stagnim, gjë që reflektohet te mungesa e trefishtë: mungesa e fuqisë blerëse, mungesa e prodhimit dhe mungesa e punësimit. Si mund të ec para ekonomia gjersa pasuria e fituar nga vjedhja e tejkalon pasurinë e fituar nga prodhimi dhe puna e ndershme?

Nëse borxhi do të përdorej për ta ndihmuar ekonominë të forcohet në disa sektorë strategjikë, ekonomia do të rritej dhe të ndihmonte në zvogëlimin e problemeve sociale dhe papunësisë.

Kuptohet, kjo kërkon vizion zhvillimor, moral të fortë dhe transparencë radikale.

(Autori është kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe deputet i Kuvendit të Kosovës)

Kosova në muajin maj importoi 10 fish më shumë sesa që eksportoi



PRISHTINE, 22 QERSHOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin maj 2018. Të dhënat nga tregtia e jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 13.1 % në muajin maj 2018, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 277.8 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 245.7 milionë eurosh në vitin 2017. Eksporti mbulon importin me 10.6 %.

Eksporti i mallrave në muajin maj 2018 kishte vlerën 32.8 milionë euro, ndërsa importi 310.6

milionë euro, që është një rënie prej (-2 %) për eksport dhe një rritje prej 11.3 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 26.9 % të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 20.7 % e përbëjnë produktet minerale; 11.3 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10.1 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 3.3 % e përbëjnë produktet bimore; 3 % e përbëjnë lëkura dhe artikujt prej saj; 2.7 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 2.3 % e përbëjnë makineritë, pajisjet

mekanike dhe elektrike; 2.1 % e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 15.8 % të importit e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 14.3 % e përbëjnë produktet minerale; 11.4 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 7.7 % e përbëjnë mjetet e transportit; 6.6 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 6.5 % e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 4.9 % e përbëjnë produktet bimore etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 11.2 milionë euro, ose rreth 34.4 % e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 51.6 %. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Austria (10.2 %), Gjermania (4.5 %), Sllovenia (3.9 %), Britania e Madhe (3.8 %), Holanda (3.4 %), Bullgaria (3 %). Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 133.2 milionë euro, ose 42.9 % e importeve të përgjithshme, një rritje prej 13.1 %. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (12.7 %), Italia (8.4 %), Spanja (2.9 %), Greqia (2.5 %), Polonia (2.2 %) etj.

Në muajin maj 2018 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 17.5 milionë euro, ose 53.5 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 5.2 %. Partnerët kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (18.5 %), Maqedonia (12.2 %), Serbia (12.1 %), Mali i Zi (8 %). Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin maj 2018 arritën në 85.5 milionë euro, ose 27.5 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 13.9 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (12.6 %), Shqipëria (6.5 %), Maqedonia (5 %) dhe B & H (2.9 %).

Gërxhaliu: Partitë politike t'i ndalin punësimet e militantëve në institucione



Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë se është shqetësues punësimi i vazhdueshëm i militantëve partiakë në institucionet e shtetit dhe në ndërmarrjet publike. Ai përmes një deklarate për gazetën "Epoka e re" ka bërë thirrje të ndalet kjo praktikë e punësimeve partiake

shumta aktuale janë duke e distancuar Kosovën nga agjenda evropiane dhe liberalizimi i vizave pasi, sipas tij, nuk janë duke u përfillur rekomandimet e Komisionit Evropian. "Informacionet e fundit me të vërtetë janë shqetësuese. Partitë politike janë të shqetësuara për punësimin e militantëve dhe kjo është duke e dëmtuar vërtet Kosovën pasi nga Komisioni Evropian gjithmonë kemi rekomandime për reformim të Administratës Publike dhe profesionalizëm të administratës. Ne kemi administratë shumë më tepër të ndikuar nga grupet e interesit dhe partitë politike sesa nga ana profesionale. Pos kësaj, shqetësues është edhe brenga për punëtorët e sektorit privat, sepse kjo gjendje është

duke e rënduar sektorin privat dhe taksapaguesit kosovarë. E tërë kjo po bën që të rinjtë të kenë pritje më shumë kah sektori publik për faktin se aty s'ka përgjegjësi dhe s'ka matje të performancës", ka deklaruar Gërxhaliu. Ai ka ripërsëritur kërkesën e tij për partitë politike që ta ndalin avazin e punësimeve partiake dhe të mendojnë për të mirën e vendit. "Si Odë Ekonomike e Kosovës apelojmë tek institucionet e vendit dhe te partitë politike që t'i thuhet stop punësimit publik dhe selektiv. Të orientohen njëherë e përgjithmonë nga vlerat", është shprehur ai. Në këtë bisedë për "Epokën e re", Gërxhaliu ka rekomanduar që të përfillen rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare. Ai ka

thënë se politikbërësit në Kosovë duhet mos të na kthejnë mbrapa sa i përket agjendës evropiane dhe liberalizimit të vizave. Kreu i OEK-ut ka reaguar edhe për rritjen e pagave të zyrtarëve qeveritarë. "Në rast se do të ndodhë rritja e pagave dhe marrja e pagave në mënyrë retroaktive, ky veprim do ta dërgojë Kosovën në një situatë më të komplikuar. E tëra kjo do të ndikojë negativisht në raportet me Bashkimin Evropian, si dhe do të jetë një hap që do ta largojë Kosovën nga qëllimi i liberalizimit të vizave. Kur kësaj ia shtojmë edhe efektet ekonomike, atëherë vërtet është shqetësuese. Apeloj që për shtet të bëhet më tepër dhe të mendohet për interesin e përgjithshëm", ka thënë Gërxhaliu.

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se partitë politike duhet ta ndalin avazin e punësimeve partiake për hir të stabilitetit financiar të vendit. "Oda Ekonomike është duke e përcjellë me shqetësim aktualitetin e punësimeve partiake. Në

kuadër të shumë dukurive të tjera negative është duke ndodhur edhe punësimi i pakontrolluar qoftë me kontrata mbi veprë, qoftë me kontrata të përhershme. Kjo po ndodh si në ndërmarrjet publike, po ashtu edhe nëpër institucionet e tjera. Ky punësim i pakontrolluar nga partitë politike vërtet është shqetësues. Pra, kjo çfarë po ndodh nuk po i bën nder Kosovës", ka thënë Gërxhaliu. Ai ka theksuar se punësimet e



Gent Begolli zgjedhet kryeshef ekzekutiv i Telekomit të Kosovës

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Bordi i Drejtorëve i Telekomit të Kosovës në mbledhjen e fundit unanimisht ka vendosur që për pozitën e kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të

Kosovës të zgjedhet Gent Begolli. Sipas një njoftimi të PTK-së, kjo përzgjedhje është bërë pas një procesi shumë transparent të udhëhequr nga komisioni i caktuar nga Bordi i

Drejtorëve të Telekomit të Kosovës dhe në përputhje të plotë me Ligjin për ndërmarrjet publike. "Fillimisht, ky komision ka përzgjedhur kandidatët në listën e ngushtë dhe, pas intervis-

timit të tyre, ka ardhur në përfundim se kandidati që mori më së shumti pikë nga paneli intervistues për pozitën e kryeshefit ekzekutiv është Gent Begolli", është thënë në këtë njoftim.

Lladrovci takon përfaqësuesit e Fondacionit Milenium Kosova

DRENAS, 22 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim Petrit Selimin, drejtor ekzekutiv i Fondacionit Milenium Kosova, Sarah Olmstead, drejtoreshë ekzekutive e MCC-së për Kosovë dhe Burim Hashanin, drejtor i Programit të Energjisë.

Lladrovci ka falënderuar për kontributin e dhënë Fondacionin Milenium Kosova dhe ka shprehur gatishmërinë e tij për ta vazhduar këtë projekt, ndërsa të pranishmit i ka informuar edhe për projektet që ka të planifikuara komuna lidhur me zbatimin e projekteve në fushën e efikasitetit të energjisë elektrike.

Ndërsa drejtori i fondacionit

Milenium Kosova, Petrit Selimi, ka njoftuar kryetarin Lladrovci se ky fondacion është implementues i programit "Threshold", në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Millennium Challenge Corporation, që është agjenci e pavarur e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për mbështetje në luftën kundër varfërisë globale. Përmes këtij programi, synohet të trajtohen pengesat e zhvillimit ekonomik, ku furnizimi i sigurt me energji elektrike është identifikuar si një ndër pengesat kryesore. Ky projekt ka për qëllim ta mbështesë rritjen e efikasitetit energjetike në ndërtesat e banimit, si dhe kalimin në ngrohje që nuk bazohet në energji elektrike.

Në kuadër të projektit parashihet



edhe mbështetja e zhvillimit të sektorit privat që ofron shërbime në fushën e efikasitetit energjetike, duke përfshirë edhe avancimin e pozitës së grave dhe kategorive të cënueshme sociale.

Në këtë takim, Petrit Selimi ka njoftuar se në fund të muajit gusht të këtij viti komunave do t'i shpërndahet një pyetësor lidhur me gjendjen e masave që kanë ndërmarrë komunat lidhur me

implementimin e projekteve në fushën e efikasitetit të energjisë dhe do të përgatiten termat e referencës për shpalljen e tenderit për kompanitë të cilat do ta implementojnë këtë projekt.

Komuna e Mitrovicës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me CBM-në



MITROVICË, 22 QERSHOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, dhe drejtoresha e Community Building Mitrovica (CBM), Afërdita Sylaj, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit "Ndërtimi i një komuniteti të qëndrueshëm në Mitrovicë", financuar nga Global Community Engagement and Resilience Fund (GCERF). Qëllimi i këtij memorandum është krijimi i një bashkëpunimi në Komunën e Mitrovicës dhe CBM-it në mbështetje të zbatimit trevjeçar të projektit "Ndërtimi i një komuniteti të

qëndrueshëm në Mitrovicë", i cili implementohet nga CBM në partneritet me OJQ "Mundësia" dhe OJQ "Open Data Kosovo". Ky projekt do ta përfshijë organizimin e shkollave të edukimit për të rinjtë, ngjarjet për përfundimin e shkollave të edukimit qytetar, duke punuar me mësuesit, prindërit, udhëheqësit e komunitetit dhe liderët fetarë. Po përmes këtij programi do të ftohen studentët e shkollave të mesme për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e vetëdijes qytetare dhe përgjegjësitë.

Brahim Mehmetaj, kryetar i Degës së AAK-së në Prishtinë

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega në Prishtinë, ka mbajtur Kuvendin e VIII Zgjedhor, ku delegatët e këtij kuvendi i kanë dhënë unanimisht besimin Brahim Mehmetajt që ta udhëheqë AAK-në në kryeqytet. Nga kuvendi doli edhe këshilli i ri drejtues i degës si dhe delegatët që do ta përfaqësojnë Prishtinën në kuvendin zgjedhor të partisë që mbahet të

shtunën në Prishtinë.

Mehmetaj ka thënë se AAK-ja në Prishtinë po rritet çdo ditë dhe këtë e dëshmoi prania aq e madhe e qytetarëve, figurave të respektuara në Prishtinë e më gjerë dhe gatishmëria e ardhjeve të reja për të qenë pjesë aktive e AAK-së dhe për t'u përballë me sfida në të ardhmen e për bashkët. "Aleanca nga ky kuvend po del më e përgatitur se asnjëherë më parë. AAK-ja do të jetë përkrah qytetarëve të

Prishtinës çdo ditë. Dua t'i falënderoj të gjitha strukturat e partisë për angazhimin dhe organizimin e këtij kuvendi madhështor, gjithashtu t'i falënderoj delegatët për besimin e dhënë", ka thënë Brahim Mehmetaj, kryetar i AAK-së, Dega në Prishtinë. Mehmetaj ka qenë edhe zëvendësministër në Ministrinë e Forcës së Sigurisë, kurse aktualisht është drejtor në Drejtorinë e Inspeksionit në Komunën e Prishtinës.



Pastrohet rruga "Gëzim Hamza-Piktori" në qytetin e Rahovecit

RAHOVEC, 22 QERSHOR (ER) - Përparim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka thënë se pas reshjeve të mëdha në ditët e

fundit, rruga "Gëzim Hamza-Piktori" në qytetin e Rahovecit ishte vërshuar nga ujërat e rrëmbyeshëm, ndërsa operatori i kontraktu-

ar nga komuna ka bërë pastrimin e rrugës dhe trotuarit të kësaj rrugë. Drejtori Krasniqi ka theksuar se intervenime në infrastruk-

turë si pasojë e vërshimeve ka pasur edhe në rrugët e tjera nëpër lokalitete të ndryshme të Komunës së Rahovecit.



HASHIM, JO QË NUK DO TA KALOSH RUBIKONIN, POR DO TË MBYTESH NË NJË PËRROSKË... KATUNDI!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Ka tre apo katër vjet që në një shkrim timin pata parashikuar se Hashim Thaçi, atëherë kryeministër i gjithëpushtetshëm dhe pronar i skenës politike në Kosovë, pavarësisht prej faktit se u ka bërë ballë të gjitha furtunave, fundin do ta ketë shumë të keq sepse do të mbytet në një përroskë... katundi. Gjenial jam dhe çuditë si jam aq i mençur apo, realisht, budalla sui generis; unë bëja parashikime që më prishnin me Hashimin të cilin aq shumë e kam dashur, kurse sot e dua edhe më shumë kurse, në anën tjetër, Basri Peçani bënte miliona me parashikime se cili është trendi rreth ushkurit. Hashimi, me patericën Bekim dhe disa milingona dembele përcjellëse, pa mandatin e Kuvendit, të dielën e ka përqafimin e radhës me Frederika Mogerinin dhe Aleksandar Vuçiqin, despotin e Serbisë dhe shkatërruesin e Kosovës. Në fakt, këtë punë e bëjnë bashkë, kush më pak e kush më shumë. Po thonë se Hashimi nuk ka mandat të bisedojë me Vuçiqin pa lejen e Driton Selmanajt, Albin Kurtit, Imer Mushkolajt dhe Behxhet Shalës. Me një fjalë, pasi e dinë se Hashimi tash nuk ka mundësi kurrë ta marrë pëlqimin e votave të mjaftueshme në Kuvend për të qenë kryenegociatori, të gjithë po këmbëngulin në këtë kërkesë të cilën presidenti ynë gjenial dhe i mençur e ka përkthyer në një thirrje për gjithëpërfshirje për interes nacional dhe shtetëror. Besoni se për këtë nuk i beson askush përveç meje, madje nuk i beson as Bekim Paterica, Enver Rrenci dhe disa hajna të tjerë që janë pjesë e orgjive dhe marrëzive parapolitike të Hashimit, që nga përfundimi i luftës. Hashimi po luan lojë të ndyrë ku është mjeshtër, por jo në kundërshtim të mandatit kushtetues që i njeh reciprocitetin e përfaqësimit gjatë negociatave me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Realisht, në bëmë përpjekje ta ndryshojmë nivelin e përfaqësimit duke e dërguar ekipin Mirëdita - Dobardan por, për shkak të së kaluarës së tyre në

UÇK, Serbia i keqtrajtoi në kufi. E bëmë përpjekjen e dytë duke e dërguar njeriun të cilin as në ëndërr nuk kam besuar se Serbia do ta refuzojë, aq më parë që është edhe pjesë e ekipit të Edi Ramës, Shkëlzen Maliqin, por edhe ky doli dhe u shpall persona non grata (person i padëshiruar) për Serbinë, duke e injoruar të kaluarën e tij. Nuk kemi zgjedhje dhe zgjidhje tjetër përveçse ta pranojmë Hashimin si kryenegociator. Albin Kurti po shtron kushte që nuk do t'i pranonte asnjë shtet edhe nëse Kosova do të ishte shumë më e fuqishme dhe të kishte një pozitë të fortë negociuese e jo kur në këtë kategori jemi kategori sociale. Ato çka po thotë Albini janë përralla sikur që do të bëja unë ta kushtëzoja Kate Upton për një lidhje të mundshme romantike dhe sentimentale. E luaja Behxhet, po modest që je! Tjetër është ta përkrahurani situatën, krejt tjetër është të ofroni zgjidhje. Albini nuk ofron zgjidhje sepse e kemi fuqinë e tredhur. Kërkohej që Hashimi të ndalet me çdo kusht për çka edhe unë pajtohem, por me çka të ndalet?! Të ndalet me konstatimin se qenka gënjeshtar, mashtrues, jokredibël dhe injorant! Këto janë fyerje dhe kurrë fyerjet nuk shndërrohen në argument. Unë, me gjithë dashurinë për Hashimin, nuk po e prodhoj asnjë efekt frenues e lëre më Albini me ato fyerje, së bashku me disa persona në LV, që fjalorin e rrugaçerisë e kanë shndërruar në kulturë komunikimi dhe mbijetesë politike. Kurrë dhe në asnjë mënyrë nuk do ta pranoj gjuhën e komunikimit dhe skajshmërisht fyes ndaj Aida Dërgutit aq më parë që e di kontributin e saj në LV, që nga ditët e para dhe se jam i sigurt se Aida ka përmbytur 100 % kombëtare. Nëse Albini po thotë se Hashimi duhet të ndalet me çdo kusht, le të organizojë protesta. Nëse LV-ja paska fituar mbi 100 000 vota, mjafton që vetëm ata që kanë votuar, të shndërruar në protestues, për 15-20 do ta rrëzonin Hashimin, bashkë me Vuçiqin dhe Mogerinin në kohën kur Zezdita është rrëzuar përtokë dhe po bën përpjekje që, duke iu lëvyrur Hashimit me cilësimin e kryenegociatorit gjenial, do të ringjallet në rolin e mashtrueses dhe bredhacakes së Brukselit. Unë e kam hallin tjetërkund, si mund ta dobësojmë dhe rrëzojmë Bekim Patericën që po mbijeton duke i ndërruar këmbët dhe jo vetëm këmbët e pushtetit! Hashimi po e luan lojën e ndyrë, atë që e bën më së miri e që është e lejueshme në këtë rajon, sidomos në Kosovë, po luan në shtig-

je afatgjata të rraskapitjes së durimit qytetar. Për model e ka demarkacionin që e kundërshtuan një kohë të gjatë, por më vonë e votuan. Hashimi deklaroi se për të qenë kryenegociator nuk i duhet pëlqimi i Kuvendit, por përkrahja e pesë ambasadave më të fuqishme në Kosovë të cilat, pas kësaj deklarate të Hashimit, nuk u deklaruan fare, prandaj i dhanë legjitimitet rrolit të Hashimit sepse u leverdis politikisht ky Hashim, por edhe të tjerët. Albini po vepron si një mjek i keq i cili konstaton se keni problem me hemorroide, ndërsa t'i futë 3-4 stenta, jo në prapnicë ku do të duhej sipas diagnozës, por në zemër. Sot, në Kosovë, më shumë problem paraqet opozita se vet pozita. Një opozitë e shkapërderdhur që nuk ofron asnjë zgjidhje apo ofron diçka që është e kundërta e zgjidhjes, është votuesi më i mirë për pozitën aktuale dhe garantues për jetëgjatësi të pozitës aq më parë që kjo pozitë është projektuar për realizimin e disa projekteve që nuk janë realizuar më parë. Ta keni parasysh faktin se, në rrethana tjera, as në ëndërr ndërkombëtarët nuk do të lejonin që Kosova të udhëhiqej nga katër komandantë (thuaja kryesorë të luftës) kurse tani, përveç se i përkrahin, disa prej tyre i lavdërojnë botërisht ndonëse, sikur në rastin e Millosheviqit që në Dejton llogaritej si ndërtesues kryesor i paqes, kishte aktakuzë aktive për krime lufte dhe kundër njerëzimit, deri te gjenocidi në Srebrenicë. Taktika e Hashimit dhe mbrojtja e Albinit: Hashimi por edhe ne që jemi më pak të mençur se presidenti gjenial e dinë se në çastin kur keni pranuar të bëheni pjesë e bisedimeve me një shtet me të cilin keni probleme të pazgjidhura, domosdoshmërisht do të bëni kompromis dhe vendimi që shkakton dhimbje nuk i takon të fortit, Serbisë por të lodhurit, Kosovës ndërsa ndërkombëtarët gjithmonë i mbajnë anën të fortit ku edhe kanë më shumë interes. Në atë moment kur keni pranuar që çështjet që janë ekskluzivisht çështje e brendshme e një shteti të hidhen në tavolinën e bisedimeve, nuk keni të drejtë të hidhëroheni apo të mendoni se jeni mashtruar. Në çdo aspekt Serbia është fituese sepse, duke i ikur çdo përgjegjësi për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit po bëhet përcaktues për çështje të brendshme të Kosovës. Nëse Hashimi, si pehlivan dhe njeri që mbijeton në saje të krizave që i prodhon vet, mund ta mashtrtojë qytetarin e Kosovës me një

armatë të madhe llaskucësh dhe me një fuqi të madhe ekonomike (jo mjete të tija) deri në masën që nuk ia ndien fare Hashimi për kundërshtimin e qytetarëve, ai e ka një mbështetje dhe përvojë nga ndërkombëtarët dhe e kaluara, jo fort e largët. Hashimi e ka të qartë se çfarëdo lloj marrëveshje që e nënshkruan me Vuçiqin, e që është marrëveshje ndërkombëtare, duhet të votohet në Kuvend. Në rrethanat aktuale këto marrëveshje kurrë nuk do të votoheshin sipas parimit të llamarinës mirëpo situata mund dhe do të ndryshojë si gjithmonë me një "kafe të mëngjesit" në njërën nga ambasadat ku do të bindeshin edhe këta që "fuqishëm" e kundërshtojnë sot se me kundërshtim po e dëmtojnë perspektivën evropiane të Kosovës dhe proceset integruese e lëre më nëse nga ta kërkon mirëkuptim (dorëzim të pakusht) ndonjë figurë e rëndësishme ndërkombëtare! Jemi të provuar me "qëndrueshmërinë e kundërshtimit" të tereqëve dhe terakesheva tona thuaja në të gjitha rastet kur kanë kundërshtuar. Me Serbinë duhet të bisedohet dhe të arrihet marrëveshje ekskluzivisht në bazë të reciprocitetit dhe nëse kështu veprohet le të jetë kryenegociator edhe vet Hashim Thaçi. Mirëpo, pas këtyre marrëveshjeve, deputetët do të detyrohen nga ndërkombëtarët apo nga e kaluara e tyre jo e pastër të votojnë këto marrëveshje dhe Hashimi do të ndahet i palagur, sikur deri më tani. E patë kur tha se me Serbinë do të bisedohet edhe për kufijtë ndonëse as vet nuk u beson fjalëve që i tha. Serbia, në rrethanat aktuale nuk do të pranonte të bisedohet për kufijtë edhe nëse kompensohet me territore të reja të Kosovës. Serbia, pa asnjë dyshim se do të përfitojë territorialisht, qoftë duke marrë territore (më vonë), qoftë duke siguruar kontroll dhe destabilizim strategjik të Kosovës përmes Asociacionit të komunave serbe dhe zonave të mbrojtura e që do të shndërrohen në njësi ekstraterritoriale. Nëse keni kapacitet për mashtrim, nuk nënkupton se keni aftësi negociuese. Po flitet se Hashimi tërë këtë po e bënë për t'i shpëtuar Gjykatës Speciale sipas raportit të Dik Martit ku Hashimi është fare yll i këtij raporti në bazë të cilit është formuar Gjykata Speciale vetëm kundër shqiptarëve, si pjesë e sistemit të Drejtësisë së Kosovës (këtu edhe unë po i bashkëngjitëm lojës së koqe... që e bëjnë ndërkombëtarët me këtë gjykatë). Nëse Hashimi është

pjesë e kërkesave për akomodim në Hagë, si mysafir i Gjykatës Speciale, jo bisedimet me Vuçiqin por edhe po të ishte vëlla i Kim Jong Unit, nuk do të shpëtojë. Millosheviqi, si njeriu me mundësi të madhe destabilizuese dhe stabilizuese, u trajtua si i tillë deri sa kishin nevojë për të ndonëse e kishte aktakuzën e ngritur! Ndërkombëtarët përdorën opozitën në Serbi sikur edhe shqiptarët e Luginës për ta dobësuar dhe rrëzuar Millosheviqin për ta paketuar pastaj Made in Serbia në Sheveningen. Çka fituan shqiptarët e Luginës me luftën që e bënë?! Asgjë përveç se i vranë, i shpërngulën me dhunë, i lanë pa identitet duke i shndërruar në pakicë të papërfillshme. Bazuar në përvojat e së kaluarës, Hashimi nuk do ta ketë fatin e mirë apo përfundimin e mirë. Po të ishte në anën e interesit të popullit dhe të shtetit, Hashimi do të bëhej me rrënjë, tash, duke ia kthyer shpinën këtij rrethi është shndërruar në dushk dhe gogla të cilat edhe era më e dobët i shkund nga degët. Nuk më vjen mirë për këtë fund por nuk ka merituar më të mirë. Hashimi, por edhe të tjerët e kanë të qartë se kur ndërkombëtarët kanë interes, menjëherë ta ndryshojnë identitetin, nga Hashim apo emër tjetër (varësisht nga interesi) të bëjnë Sanader. Sa për fillim. Për këtë gjendje nuk është fajtor i vetëm Hashimi, të gjithë kemi përgjegjësi prandaj të gjithë po i bartim dhe do t'i bartim pasojat, sidomos pas "marrëveshjes historike". Më herët, Baca Adem, me të parë se nuk jemi askund thoshte: "hajt Bacës, as nuk po na pyesin e as nuk po na dëgjojnë prandaj duhet të këqyrim seri. Do të vjen një kohë kur askush nuk do të mbetet pa u koritur dhe se do të na dhimben këta shokët tanë...". Doli ashtu si e parashikoi Baca, u koritën deri në pikën e fundit e se a na dhimben, është pikëpyetje e madhe ndonëse nuk është njerëzore të kënaqeni me vuajtjet dhe pësimet e të tjerëve. Deri sot ishin mazohistë, në të ardhmen duket se do ta përqafojmë sadizmin, jo nga vullneti ynë por nga kontributi i të tjerëve. Po më dhimbet Hashimi që do të deklasohet nga Vuçiqi që edhe nuk do të jetë befasi. Në fund të fundit a nuk e deklasoi Kroacia Argentinën e që ishte befasi. E tash një prognozë për fituesin e botërorit. Mbajeni mend, nëse Argjentina, mrekullitë ndodhin, arrin të kualifikohet më tutje, do të bëhet kampion botëror.

Tajani: Armiku tregtar i ShBA-së nuk është Evropa

Romë, 22 qershor - Për sa iu përket tarifave të metaleve, presidenti amerikan Donald Trump ka bërë një zgjedhje që në gjykimin tim është e pamatur dhe e nxituar, deklaroi presidenti i Parlamentit Evropian, Antonio Tajani. "Armiku tregtar i ShBA-së nuk është Evropa. Armiku tregtar

i amerikanëve është Kina. Me Kinën kemi probleme edhe ne, sidomos për sa i përket çelikut, biçikletave, aluminit dhe qeramiks", theksoi Tajani. "Ka një mbiproduhim të produkteve kineze dhe Kina përpiqet t'i zgjidhë problemet e saj duke pushtuar tregjet tona", tha ai. "Dhe me këtë

nuk mund të mendojmë të shkojmë më tej, nëse duam ta mbrojmë industrinë tonë, ndërmarrjet dhe punësimin pasi autarkia sjell vetëm dëm industrial", tha ai. "Evropa dhe Italia pa industri dhe pa biznese janë të destinuar ta shohin rritjen e papunësisë", tha Tajani.



Të dielën në Turqi mbahen zgjedhjet legislative dhe presidenciale. Erdogan sqaron funksionimin e sistemit presidencial të qeverisjes

Në garën për president, gjashtë kandidatë

Nesër (e diel) do të zhvillohen zgjedhjet legislative dhe presidenciale në mbarë Turqinë. Më shumë se tre milionë turq që jetojnë jashtë vendit kanë të drejtën e votës në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare



ANKARA, 22 QERSHOR - Nesër (e diel) do të zhvillohen zgjedhjet legislative dhe presidenciale në mbarë Turqinë. Më shumë se tre milionë turq që jetojnë jashtë vendit kanë të drejtën e votës në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Në zgjedhjet presidenciale garojnë gjashtë kandidatë, ndërsa në ato parlamentare tetë parti politike. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan sqaroi sistemin e ri presidencial të vendit, në prag

të zgjedhjeve të përgjithshme dhe presidenciale që zhvillohen të dielën. "Në sistemin presidencial do ta ulim numrin e ministrave në 16", theksoi Erdogan.

Ai përmendi ministrat që nuk do të prekeshin që do të jenë Ministria e Drejtësisë, e Punëve të Brendshme, e Mbrojtjes, e Arsimit, e Shëndetësisë, e Energjisë dhe Burimeve Natyrore, e Mjedisit dhe Planifikimit Urban, e Kulturës

dhe Turizmit, e Rinisë dhe Sporteve, e Thesarit dhe Financave, e Transportit dhe Infrastrukturës, e Punëve të Jashtme, Sociale dhe Familjes, e Bujqësisë dhe Pylltarisë, e

Industriisë dhe Teknologjisë dhe ajo e Tregtisë.

Duke theksuar se sistemi i ri duhet ta inkurajojë ndarjen e pushtetit, Erdogan theksoi se lidhja mes Qeverisë dhe parla-

mentit do të reduktohet. "Në sistemin e ri Qeveria do të jetë e autorizuar vetëm për dorëzimin e projektbuxhetit parlamentar. Autorizimi për projektin parlamentar u referohet vetëm parlamentarëve", theksoi presidenti turk.

Si një reformë tjetër brenda sistemit të ri të Qeverisë, Erdogani shtoi se do të themelohen katër zyra të rëndësishme. "Në fazën e parë, katër zyra për burimet njerëzore, investimet, financat dhe transformimi digjital do të mbajnë një përgjegjësi të madhe në modelin e ri, pasi do të jetë pothuajse stafi më i afërt i presidentit", theksoi Erdogan. Ai përmendi ndryshimet në ekonomi sipas modelit të ri.

BE-ja fillon zbatimin e tarifave ndaj importeve amerikane



BRUKSEL, 22 QERSHOR - Bashkimi Evropian nis të premtën zbatimin e tarifave për një sërë importesh amerikane. Turqia ka njoftuar se do të vendosë tarifa ndaj produkteve amerikane si përgjigje ndaj tarifave të çelikut dhe aluminit. BE-ja po vendos tarifa mbi disa produkte, përfshirë motoçikletat Harley - Davidson, cigaret, boronicën e kuqe dhe uiskin, kjo si lloj përgjigje ndaj vendimit të presidentit amerikan Donald Trump për vendosjen e tarifave ndaj

çelikut dhe aluminit që vjen nga Evropa.

Trumpi ka thënë se masat kundër çelikut dhe aluminit të BE-së kanë pasur si qëllim t'i mbrojnë interesat e sigurisë kombëtare, por frika që kanë pasur gjithnjë prodhuesit amerikanë të uiskit është duke u bërë realitet. "Pra, një shishe uiski 50-dollareshe, në vend që të shitet 50 euro, tani do të shitet diku në 62.5 dhe ky është një ndryshim i madh në çmim", thotë Scott Harris i distilerisë Catocin Creek.

Tregjet e huaja janë bërë shumë fitimprurëse për prodhuesit amerikanë të uiskit, por vendosja e tarifave mund t'i detyrojë ata të përqendrohen në tregun vendas.

Turqia ka njoftuar se do të vendosë tarifa ndaj produkteve amerikane si hakmarrje ndaj tarifave të çelikut dhe aluminit. Organizata Botërore e Tregtisë njoftoi se tarifat e reja të Turqisë do të arrijnë në 266.5 milionë dollarë për produkte që përfshijnë makinat, qymyrin, letrën, orizin dhe duhanin.

Rusia akuzon Perëndimin se fabrikoj prova për sulmet kimike në Siri

MOSKË, 22 QERSHOR - Moskë tha se Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre kanë fabrikuar prova për t'i implikuar forcat e Qeverisë siriane në sulmet me armë kimike kundër civilëve. Zyrta i Ministrisë ruse të Mbrojtjes, Igor Kirillov, komandant i forcave të rrezatimit, kimike dhe biologjike, tha se sulmi i dyshuar kimik në qytetin Khan Sheikhon, më 4 prill, ka qenë provokim i organizuar nga grupi sirian i ndih-

mës Helmetat e Bardha dhe sponsorët e tyre. Qeveritë perëndimore dhe inspektorët e Kombeve të Bashkuara kanë fajësuar forcat e Qeverisë siriane për këtë sulm, i cili ka lënë së paku 74 njerëz të vrarë dhe mbi 550 të plagosur.

Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, tha se Qeveria siriane ka gjetur pajisje për prodhimin e armëve kimike në qytetin e Dumës, pasi ky i fundit ka rënë nën kontrol-

lin e luftëtarëve antiqeveritarë. "Një pjesë e pajisjes, e cila ishte profesionale nga pikëpamja e ekspertëve, fatkeqësisht është prodhuar në vendet e Evropës Perëndimore", tha Zakharova, duke shtuar se Moskë është e gatshme të ofrojë dëshmi të këtij pretendimi. Komentet vijnë para se Kombet e Bashkuara të dalin me një raport për një sulm të dyshuar kimik që ka ndodhur muaj më parë në qytetin Duma.



DËSHMORËT NUK JANË THJESHT OBJEKT PËRKUJTIMI

- Fjalë rasti në akademinë përkujtimore
për dëshmorët Imer dhe Labinot Krasniqi,
Prishtinë, më 16. 6. 2018



Prof. dr. Kudusi LAMA,
gjeneral në pension

Të nderuara familje të dëshmorëve Imer e Labinot Krasniqi,

Të nderuara familje të dëshmorëve të kombit,

Të nderuar pjesëmarrës në këtë Akademi Përkujtimore,

Përkujtimi i dëshmorëve është vlerë për lirinë që rrit autoritetin e përkujtuesve, por që kërkon edhe përkushtim për përsosjen e rrugës nëpër të cilën na kanë orientuar dëshmorët të ecim drejt ardhmërisë.

Dëshmori i parë i anës së Malishevës, Imer Krasniqi, me emrin e tij solli portretin e luftëtarit të lirisë, me emrin e tij bëri një luftë, me emrin e tij krijoi një simbol frymëzimi e mobilizimi për UÇK-në, me emrin e tij krijoi një legjendë, me emrin e tij solli një dëshmor, me emrin e tij krijoi një brigadë luftëtarësh që është vlerësuar një prej brigadave më të mëdha të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Imer Krasniqi dhe Labinot Krasniqi i përkasin një familjeje të sprovuar për çështjen kombëtare, ndaj nuk mund të mos ishin në frontin e luftës për liri. Dhe këtë liri ata nuk e kërkuar për familjen e tyre, për fisin e tyre a për krahinën e tyre, por për të gjitha trojet shqiptare. Fakti i qenies së të dyve dëshmorë të kombit, por që e kanë dhënë jetën njëri në trevat e Kosovës e tjetri në trevat e Maqedonisë, është tregues i vizionit të tyre kombëtar.

Imer e Labinot Krasniqi dhe të gjithë dëshmorët e tjerë i morën armët për ta bërë atdheun e tyre dhe popullin e tyre të lirë.

Është e ditur se edhe dëshmorët e kanë dashur jetën, por për lirinë e kanë vënë atë në provë, duke arritur ta finalizojnë me rënie në altarin e lirisë. Ama të rënë kanë lënë të gjallët pas vetes për ta ndërtuar atë të ardhme për të cilën ata kanë dhënë jetën. Por dëshmorët nuk janë thjesht objekt përkujtimi. Dëshmorët sot nuk e dinë

nëse ne e përkujtojmë veprën e tyre ose jo. Kështu që veprime të tilla nuk duhen trajtuar sikur ne po u bëjmë dëshmorëve ndonjë nderim. Ata fizikisht nuk kanë nevojë për nderimin tonë. Ata janë në amshim të lumtur për veprën e tyre edhe pa përkujtimin tonë.

Prandaj është mirë t'i thërrasim mendjes e ta bëjmë pyetjen për të gjallët, për vete dhe për gjithë të tjerët: A po e bëjmë ne punën tonë sot sipas kriterëve të idealeve për të cilën luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës luftuan dje? A jemi ne në nivelin që ta shikojmë veten drejt në sy duke dalë para portretit të dëshmorit? A kemi ne të fshehta për të cilat duhet dhënë llogari, por vetëm se nuk na i dinë të tjerët? Çfarë i themi vetes kur jemi vetëm, për atë se si e bëjmë punën e sa të përkushtuar jemi për sendërtimin e rrugës drejt të ardhmes, në segmentin ku jemi ngarkuar të punojmë? Cilat janë sfidat me të cilat do të ndeshemi në të ardhmen e afërt dhe të largët? Cilat janë synimet që kemi secili në pozicionin e tij për ta zhvilluar vendin dhe për ta lumturuar atdheun e kombin? A kemi lakmi dhe interesa jetëshkurtra personale dhe klanore partiako-politike? A e nderojmë me punën tonë gjakun e dëshmorëve? A shprehemi në emër të popullit duke bërë abuzime mbi interesat e tij? Etj.

Dëshmorët janë institucioni më i vlefshëm i të gjitha kombeve të botës. Janë institucioni më i nderuar, janë institucioni i krenarisë kombëtare dhe të gjithë betimin e bëjnë duke u mbështetur në vullnetin e Zotit dhe gjakun e derdhur nga dëshmorët. Dëshmorët në çdo komb janë institucioni i sigurisë kombëtare, pasi çdo qytetar i kombit përkatës e ka për detyrë të ruhet shenjtëria e gjakut të derdhur dhe të mos lejohet të shkelet për asnjë arsye dhe prej askujt, duke pranuar që më mirë të shuhen kombëtarisht sesa të lejojnë të shkelet ai gjak nga armiku.

A e ndiejmë ne veten kombëtarisht të qetë për qëndrimin që mbajmë ndaj gjakut të dëshmorëve dhe punën që bëjmë për të ndërtuar të ardhmen e vendit duke u ballafaquar me atë çfarë kemi biseduar me dëshmorin kur ai ose ata ishin në front me ne duke luftuar denjësisht për të fituar e gëzuar

lirinë?

Është bërë traditë fjalomania deklarative, "të ecim vertikalisht, të qëndrojmë vertikalisht, të paraqitemi vertikalisht, të shkojmë vertikalisht", ndërsa në fakt në mjaft raste po shohim se po ecim përtokazi, me zvarritje, me përlulje, me buzëqeshje të shtira, me rrahje supesh përkëdhelëse, që duket se po zënë vend në portretet e atyre që nuk duhet të zënë vend. Që duket se po zënë vend në jetën tonë, duke na e zbehur dinjitetin dhe identitetin, çka nuk është në dinjitetin e luftës nëpër të cilën kemi ardhur deri në këto ditë lirie dhe nuk është në dinjitetin e figurës së dëshmorëve të atdheut, të cilët rrugëtuan nga frontet e luftës drejt pedestalit të lavdisë kombëtare, duke na lënë detyrën më të vështirë për të kryer, atë të ndërtimit të së ardhmes së lumtur të atdheut e kombit. Prandaj edhe në çdo hap që hedhim, për të qenë në hapin e amanetit të dëshmorëve, duhet ta shikojmë veten dhe ta pyesim atë: A jemi vërtet vertikalisht?

E në qoftë se duam të jemi seriozë në këtë qëndrim, duhet ta kthejmë vështrimin mbi portretin e dëshmorëve dhe të shikojmë vërtet: A u kemi dhënë atyre një dekoratë trimërie? A ka trimëri më të madhe se ta japësh jetën në frontin e luftës kundër armikut për t'i dhënë liri vendit e popullit tënd? Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që e konsiderojmë modelin e zhvillimit, edhe kur dikush fikën një zjarr në pyll, bëhet një ceremoni nderimi për të dhe i jepet një medalje trimërie. A edhe sa ai që fikën një zjarr në Amerikë nuk paskan bërë dëshmorët tanë? Mohimi i rrugës nga kemi ardhur nuk është siguri për të ardhmen. Përkundrazi, ky mohim a zhvlerësim, quajeni si të doni, e bën shumë të pasigurt në ardhmen e vendit.

Sot në Kosovë më shumë e ngrënë zërin ata që nuk kanë marrë pjesë në luftë. Më shumë e ngrënë zërin ata që shpifin për luftëtarët e çlirimit. Ata që të gjithë luftëtarët përpiqen t'i identifikojnë me një a dy abuzivë që ndoshta gabimisht mund të jenë gjetur në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ashtu sikurse me qëllim dashakeq të atyre që janë gjetur në frontin e gabuar kombëtar, për të mos thënë në frontin bashkë me armikun përballë atdheut të tyre, kanë nxjerrë një formulë, që denigron koman-

dantët e të gjitha rangjeve të asaj ushtrie të lavdishme, duke u përpjekur që termin komandant në atë ushtri në opinion ta bëjnë të neveritshëm. Imagjini kur opinioni neveritë komandantët, çfarë duhet thënë për ushtarët. Prandaj duhet ngritur zëri fort. Atij që përpiket ta përçmojë luftën çlirimtare të Kosovës dhe luftëtarët që e bartën atë luftë dhe e sollën në vlerat kombëtare shqiptare duhet t'i tregohet vendi. Të mbrohen pra me arsytetime të qëndrueshme vlerat e kësaj lufte dhe të çlirimtarëve qofshin ata komandantë a luftëtarë të thjeshtë të atyre radhëve.

Nëse është dikush nga luftëtarët, që pas luftës ka ndërtuar figurë të keqe, të kriminalizuar, të pamoralshme a diçka të tillë, unë mendoj që atij duhet t'i japim një dekoratë të lartë për luftën që ka bërë dhe ta marrin ligjet e shtetit në dorë e ta dënojnë me 101 vjet burg për të këqijat e tij të pas luftës. Por, të thuhet shiko çfarë bën ky apo ai i luftës, askush nuk ka të drejtë të prekë. Ajo është shenjtëri kombëtare.

Sot përkujtojmë dëshmorët e rënë, por edhe secili nga ata luftëtarë që jetojnë sot në Kosovë me apo pa punë, me apo pa detyra të ulëta a të larta qytetare a shtetërore, mund të ishte dëshmor, sepse edhe këta në një front me ata që kanë rënë kanë qenë.

Një çështje tjetër që ma tërheq vëmendjen e që dua të përfitoj nga rasti për ta ndarë me ju në këtë akademi përkujtimore është fakti që sot po bëhen shumë lojëra fjalësh me sasinë e luftëtarëve që kanë marrë pjesë në luftën çlirimtare të Kosovës e që evidentohen si luftëtarë të asaj lufte, duke marrë dëshmi ligjore për këtë nga shteti i Kosovës.

Arrihet deri atje, sa të thuhet se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka pasur 10 deri 15 mijë luftëtarë. Dikush thotë se po të kishte aq luftëtarë sa janë evidencuar si veteranë ne jo vetëm kishim çliruar Kosovën, por e kishim pushtuar edhe Beogradin. Habitem me këta strategë të mëdhenj me përmasa vigane të pas luftës, se gjatë luftës ka shumë mundësi të kenë qenë të veshur me dimi a me fustan duke ikur diku, siç edhe i kam parë disa.

Dikush arrin deri atje sa të thirret në armët e dorëzuara në KFOR nga UÇK-ja në vitin 1999. Unë nuk mund ta shtjelloj këtë çështje publikisht, por mund të them se të thirresh në këtë shifër

është abuzimi më i madh që mund t'i bëhet historisë.

Ndërkohë unë dua të jap vetëm dy shifra, që secili nga ju t'i bëjë vetë llogaritë. Në përfundim të luftës, më 9 qershor 1999, Operacioni Shigjeta, në frontet e Koshares dhe të Pashtrikut kishte mbi 5 000 luftëtarë. Ndërsa po në këtë ditë Zona Operative e Dukagjinit kishte mbi 8 000 luftëtarë.

Ju lutem merrini luftëtarët e të gjitha zonave, si dhe të gjithë ata që kanë qenë pjesë e kësaj lufte jashtë Kosovës, në mbështetjen logjistike dhe financiare e mediatike të saj dhe nxirri përmasat e asaj ushtrie. Që realisht kishte përballë mbi 60 000 ushtarë serbë, mbi 12 000 policë serbë dhe mbi 63 000 civilë të armatosur serbë. Të gjithë janë të lutur që pakënaqësitë e sotme, kundërshtitë e sotme, politikat e sotme, konfliktet e sotme, përplasjet e sotme, të mos i mbartin të lufta çlirimtare e Kosovës dhe të bartësja e saj - Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Të gjithë luftëtarët duhet të jenë krenarë për veprën e tyre madhore kombëtare. Të gjithë frikacakët e djeshëm mos të bëhen trima sot, por të qëndrojnë në pjesën e tyre të moralit kombëtar. Të gjithë tradhtarët e djeshëm le ta hedhin tej tashmë tradhtinë e tyre e të kthehen t'i shërbejnë vendit, në qoftë se nuk janë ende në borderotë serbe të bashkëpunimit.

Dhe në vijim evidentoj se lufta çlirimtare e Kosovës nuk ka filluar as më 24 mars 1999 e as më 22 prill 1999. Lufta publike e hapur, me kombinimet e luftës partizane me luftën frontale, ka filluar jo më vonë se kur Ushtria Çlirimtare mori nismën për të dalë publikisht me një mesazh për të gjithë shqiptarët. Dhe kjo ka ndodhur më 28 nëntor 1997.

Dëshmorët janë amaneti që vjen nga dheu i kombit i gatuar me gjakun e tyre. Luftëtarët janë amanetqarët të cilët kanë shumë detyra për të kryer. Po menduam se lufta ka mbaruar jemi të humbur. Po menduam se kemi kryer obligimet e amanetit të dëshmorëve jemi duke punuar kundër lirisë dhe ardhmërisë kombëtare. Unë nuk dua të jem prej atyre që harrojnë, as prej atyre që vetëkënaqen e as prej atyre që e kanë rrezën e shikimit deri te hunda e tyre. Dua të mbetem ushtar gjithë jetën.

Lavdi dëshmorëve Imer e Labinot Krasniqi!

Lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Nderim për ju të nderuar pjesëmarrës.

Faleminderit që më dëgjuat!

Johnny Depp tregon se varet nga alkooli



Aktori Johnny Depp tregon më në fund të vërtetën jo vetëm për gjendjen e tij fizike muajt e fundit. Aktori 55-vjeçar ka tronditur fansat dhe mediet, teksa në një intervistë të rrallë rrëfen përballjen me depresionin, paratë, dashurinë për

drogat, përfshirë edhe qetësuesit në çdo orë të ditës. Depp tregon për herë të parë se ndarjen nga ish-bashkëshortja Amber Heard e ka përjetuar shumë keq, aq sa ra në depresion dhe vuri në rrezik edhe financat e tij.



Ish-sulmuesi i Milanit do të bëhet baba

Pippo Inzaghi, trajneri i ri i Bolonjës dhe ish-sulmuesi i Milanit, pritet që së shpejti të bëhet baba. Revistat rozë në Itali zbulojnë se partnerja e tij Angela Robusti, ish-Miss Veneto, është në

pritje të një fëmije. Zërat për një lajm të tillë nisën dy javë më parë, kur Pippo është prezantuar me të dashurën e re në dasmën e të vëlait, Simone. Ndërkohë fëmija pritet të lindë në fillim të nëntorit.

Khaketa e Melania Trumpit shkakton "stuhi" në ShBA



Mbishkrimi që mbante mbi xhaketë Melania Trump ka shkaktuar polemika në ShBA. Zonja e Parë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është vënë orët e fundit në qendër të kri-


tikave, si rrallëherë, për zgjedhjen në veshje. Gjatë vizitës në një qendër në Teksas, Melania Trump kishte veshur një xhaketë në të cilën ishte shkruar "Nuk më intereson fare, po ty?"

XXXTentacion po priste të bëhej baba



Reperi XXXTentacion priste të bëhej baba i një fëmije me të dashurën e tij. Kështu ka konfirmuar Cleopatra Bernard e dashura e reperit 20-vjeçar, i cili u

vra gjatë kësaj jave në Florida të ShBA-së. "Ai na la dhuratën përfundimtare", ka shkruar e dashura e tij në llogarinë e saj në "Instagram".

Autor : GAZMEND MORINA	AKTORI NË FOTO	VENDLINDJA E ODISEUT	SHENJË QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR (sh.shq.)	EPOSI	NOTË MUZIKORE	ZANORE	EPOKA ERE	SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE	PËRSHTATJE	UDHËHEQËS I NJË ORGANIZATE	VENDI KU NIS NJË RRJEDHË UJI (sh.shq.)	SOUTHERN INSTITUTE TECHNOLOGY	 1						
NDËRTESE A VEND I POSAÇËM, KU SHFAQEN FILMA							BARKAS; KËMBADORAS FILMI I PARË SHQIP												
PËRFYTYRIM IDEAL I SHOOËRISË NJERËZORE						NDESHJA FILOZOFI GJERMAN IMANUEL													
VEGËL BUJQËSORE (shq.)					ELEKTRODAT E POLIT NEGATIV BASHKËTING-ËLLORE														
TOMPKINS KARATE ASSOCIATION				PËRMIRËSIM, SANACION (sh.shq.) SHKOLLIMI									GJAKATARI, KRIMINELI						
KËSTI BANKAR PËR KTHIMIN E KREDISË					NAIM ABAZI PASION I TEPRUAR PËR DIÇKA			MOR, HEJ GJERMANI I VJETËR				BASHKËTING-ËLLORE NJËSIA MONETARE BAZË E SHQIPËRISË							
ZANORE		DYPALËSH	REOMIR, METËR, TON FUTBOLLISTI FRANCEZ ABIDAL (Barcelona)				ADEM DEMAÇI BASHKËTING-ËLLORE			NOTË MUZIKORE FOSFOR									
VAJZA E DJALIT A E VAJZËS						VIDEO SPOTET MUZIKORE E FILLOVA							SHKRONJA XXVIII	FLORI	KORNIZË	NITROGJEN	SHUMË I MADH, GJIGANT		
AKTORJA JONË MORINA							ERMELINDA MEKSI ILVA DARE			VEGËL MUZIKORE (sh.shq.) KA, DEM									
MËNJANIM NGA GARA								PJESA E MISHTË E TRUPIT PJESË RROTULLUESE E NJË MAKINE					PAJTUESHM-ËRI (krah.) PRODUKT I QUMËSHITIT						
PIJE ALKOOOLIKE, QË NXIRRET NGA LËNGU I RRRUSHIT					SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË FAZA, ETAPA						ILAZ KODRA NË ANË, ANËS			KOHË GJYNAH					
ENEIDA TARIFA			"M" para dy "S" RIFAT AVDIU				KËNGËTARJA ISTREFI					OLIVIER MARTINEZ PARI (sh.shq.)			TANTAL AKTORJA AMERIKANE MEG (shqip.)				
AKTORJA BUDAKOVA						IGLI TARE PUNËTORET E TEATRIT TË KUKULLAVE				NË DITËN VIJUESE CILËSIA E NJË SENDI A E NJË DUKURIE							NANCY BASHKËTING-ËLLORE		
EPOKË (shq.)				ANGERS "EPOKA E RE"		ZANORE		VEZAK METAFORË E GJATË					KAFSHË SHTËPIAKE (shq.) PËREMËR VETOR						
TEDI ALVES			AKTORJA & KËNGËTARJA NË FOTO 2 ZANORE																KOLORADO LIGJ, KANUN (vjet.)
PARAARDHËSI YNË						IRMA LIBOHOVA NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE			TOKIO RAVENA		VIGAN, KOLOS NJË NGA DHOMAT E SHKOLLËS								MJET UDHËTIMI E TRANSPORTI
2					NJË KONTINENT								"IRLANDA"	SPORT UJI VEPRIMTARI HASANI (shq.)					
					NAGANT (shk.)			FUTBOLLISTI SHQIPTAR LALA DY BASHKËTINGËLLORE							MAGJISTËR (shk.) KËNGËTARJA KOÇI				
					GRIMCË MOLEKULARE				ZANORE ZOG I EGËR GRABITQAR, I NGJASHËM ME BUFIN		"RAGBI" TË BUKURIT (shq.)				ZANORE MËSYMJE, SULM				
					KËSHTJELLA, KALAJA								SHTET I MADH NË AZI IRIIDIUM, VOLT						
					ORINDA (perkdh.)			GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.) MINUS (mat.)											NITON
					VRANËSIRË			PAMELA ANDERSON BASHKËTING-ËLLORE			POLITIKANI SHQIPTAR SHEHU TOTENHAM								
					ZBAVITËS, TËRHEQËS									VEPËR E KRYER					



ZGJIDHJA E FJALËKRËYQIT: KINEMA, KALAS, UTOPI, TAKIMI, SHATI, KATODAT, TKA, SANIMET, RATA, NA, OR, K, I, RMT, AD, LA, MBESA, KLIPET, SHIRINE, EM, KITARAT, ELIMINIM, TUL, RAZI, RAKI, IDARE, IK, MOT, ET, MSS, NORA, OM, TA, MERITA, IT, MESHËR, N, ERA, A, OVAL, KALI, TA, EDONA RESHITAJ, K, ILIRI, IL, T, TITAN, AMERIKA, NOT, NAG, ALTIN, MR, ATOM, A, RAG, E, FORTESA, IRAN, ORI, RARITET, RE, PA, TRITAN, ATRAKTIV, AKT.

Relaks dhe mirëqenie, 10 destinacionet më të mira në Botë

Cilat janë destinacionet më të bukura në botë ku udhëtarët mund të relaksohen dhe të përqëndrohen në mirëqenie, vetë-kujdes, yoga dhe meditim? Bali, Rishikesh dhe Sedona, para së gjithash. Por, ka edhe vende të tjera të këndshme për të shpëtuar nga kaosi dhe stresi dhe mund të relaksoheni me Spa dhe ushqim të shëndetshëm. Le t'i zbulojmë.

Turizmi i shëndetit dhe mirëqenies është një trend në rritje dhe numri i udhëtarëve që kërkojnë mirëqenie shpirtërore dhe fizike gjatë udhëtimit të tyre është gjithnjë në rritje. Sipas një studimi nga 'Global Wellness Institute', shpenzimet për udhëtimet e lidhura me mirëqenien regjistruan një rritje prej 14% krahasuar me 2013 dhe mund të tejkalojnë 800 miliardë dollarë deri në vitin 2020. Këtu janë Top dhjetë prej destinacioneve të padiskutueshme, sipas një sondazhi të 'TripAdvisor'.

1. Bali, Indonezi – Vetëm vendosni këmbën në ishullin e perëndive për t'u ndjerë menjëherë i relaksuar dhe në ekuilibër me mjedisin rrethues. Midis

plazheve piktoreske, natyrës së harlisur, vendeve të pabesueshme për zhytje dhe shumë qendrave yoga, paqja është e siguruar.

2. Rishikesh, Indi – Qyteti i shenjtë që ngrihet në veri të Indisë ka një domethënie të thellë shpirtërore dhe kulturore për popullatat lokale. Ju mund t'i jepni vetes një leksion yoga për të përkëdhelur mendjen tuaj ose të hyni në kontakt me natyrën duke udhëtuar.

3. Sedona, Arizona, Shtetet e Bashkuara – E vendosur në zemër të shkretëtirës së Arizonës, Sedona është një oazë e vërtetë ku udhëtarët mund të ndalojnë dhe të mbushen me energji. Është për t'u admiruar bukuria e peizazheve natyrore; pas perëndimit të diellit ju mund të shijoni spektaklin e një qielli të pabesueshme të ndritshëm.

4. Hepburn Springs, Australi – Rrethuar nga zona me përqendrimin më të lartë të burimeve minerale të Australisë, Hepburn Springs është një qytet i njohur termal. Udhëtarët mund të provojnë ujërat termale lokale dhe të gëzojnë një qëndrim në një nga hotelet me spa.



1

5. Ko Samui, Tajlandë – Ky qytet i vogël i lindur si një fshat peshkimi ka një bukuri të veçantë dhe një atmosferë shumë relaksuese. Zhytuni në kulturën lokale, duke vizituar një tempull budist ose duke kaluar ditën në një nga qendrat e shumta spa.

Kosta Rika – Udhëtarët që kërkojnë një vend për të përmirësuar mirëqenien e tyre psikofizike duhet të marrin në konsideratë një udhëtim në Kosta Rika, ku ata mund të kryejnë trajtime relaksuese siç janë mbyllja e trupit ose hidroterapi ose thjesht të hyjnë në kontakt me

natyrën, duke ecur zbathur në rërë.

7. Goa, Indi – Të shëtisësh në plazhet me rërë të bregut të Goas është fillimi i përsosur për një pushim detoksifik. Ju mund ta filloni ditën me një leksion yoga, duke harruar rutinën tuaj të përditshme dhe përsëri, të zhytni veten në kulturën lokale me një leksion të kuzhinës tradicionale.

8. Zermatt, Zvicër – Një fshat pa makina, me chalets luksoze që ofrojnë trajtime spa të panumërta të rrethuara nga natyra që të lë pa frymë. E gjithë kjo gjatë një qëndri-

mi në Zermatt, në këmbët e Matterhorn.

9. Maldive – Shijoni perëndimin e bukur pas një shëtitjeje në bregun e një prej plazheve të këndshme të Maldive. Ose në një nga qendrat spa të saj.

10. Ibiza, Spanjë – Ibiza nuk është vetëm party dhe festa të zhurmshme, në ishull ju gjithashtu mund të gjeni ferma të bukura tradicionale që mbajnë shkolla yoga dhe vendpushime në bregdet që ju lejojnë të admironi lindjen e diellit duke bërë Pilates.



2



3



4



5



6



7



8



9



10

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SOUTH KOREA - MEXICO

2

GERMANY - SWEDEN

1

BELGIUM - TUNISIA

1

Brazili fiton me mund të madh ndaj Kosta Rikës

Brazili ka grumbulluar katër pikë dhe është afër kualifikimit në fazën tjetër, pasi të premten e mposhti Kosta Rikën (2-0). Kualifikimit i është afuar edhe Nigeria që e mposhti Islandën (2-0), por Nigerisë i duhet një barazim në ndeshjen e fundit ndaj Argjentinës

"Epoka e re"

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Kombëtarja e Brazilit është dashur të djersitet fortë për t'i marrë tri pikë nga ndeshja ndaj Kosta Rikës, pasi dy golat e fitores i shënoi në minutat shtesë të ndeshjes. Dominimi gjatë gjithë ndeshjes ishte në anën e brazilianëve, por sulmet përfundonin pa sukses. Formë të mirë tregoi edhe portieri i Real Madridit, Claudio Bravo, i cili disa herë ndali gjuajtjet e yjeve të Brazilit. Kur u prit që ndeshja të mbyllej 0-0, në skenë doli ylli i Barcelonës, Philippe Coutinho, që shënoi golin e parë për brazilianët në minutën e parë të kohës shtesë, kurse fitoren 2-0 e vulosi Neymari në minutën e gjashtë shtesë. Brazili pas kësaj fitore është afër kualifikimit, pasi ka grumbulluar katër pikë. Në anën tjetër Kosta Rika edhe përkundër lojës së mirë nuk arriti t'i gëzohet pikës së parë në këtë Botëror. Në ndeshjen e Grupit D, Nigeria e ka mposhtur Islandën me rezultat 2-0. Në

pjesën e parë të ndeshjes që u zhvillua në "Volgograd Arena" nuk kishte gola, por në pjesën e dytë Nigeria e filloi fuqishëm duke shënuar në minutën e 49, kur sulmuesi i CSKA-së, Ahmed Musa e dërgoi topin në rrjetën e islandezëve. I njëjti futbollist e shënoi edhe golin e dytë dhe të fundit në ndeshje në minutën e 75-të. Islanda e pati mundësinë të rikthehet në lojë shtatë minuta nga fundi, por Gylfi Sigurdsson ishte i pasaktë nga penalltia, duke e goditur topin lart portës së portierit Francis Uzoho dhe ndeshja përfundoi 2-0. Pas kësaj fitore Nigeria është afër kualifikimit, por i duhet vetëm një barazim në ndeshjen ndaj Argjentinës për të siguruar një gjë të tillë. Islanda në ndeshjen e fundit luan ndaj Kroacisë, e cila është kualifikuar për fazën tjetër.

Sot zhvillohen tri ndeshje, Gjermania kërkon fitoren e parë

Të shtunën në program janë tri ndeshje të Kupës së Botës dhe



vëmendja kryesore do të jetë në ndeshjen Gjermani - Suedi, e cila zhvillohet në stadiumin "Fisht Stadium" nga ora 20:00. Gjermanët janë në kërkim të fitores së parë dhe mbetjes në garë për kualifikim në 1/8 e finales. Ndryshe nga kampionët e Botës, Suedia e ka fituar ndeshjen e parë dhe një pikë ndaj Gjermanisë do të ishte e mjaftueshme për këtë reprezentacion. Në ndeshjen

tjetër të Grupit F, Meksika kërkon edhe fitoren e dytë ndaj Koresë së Jugut për ta siguruar kualifikimin. Ndeshja tjetër në Grupin G në mes të Belgjikës dhe Tunizisë zhvillohet nga ora 14:00. Belgët e kanë fituar ndeshjen e parë ndaj Panamës me rezultat 3-0. Në këtë ndeshje mund të aktivizohet edhe mesfushori shqiptar Adnan Januzaj, i cili është pjesë e Belgjikës në këtë Botëror.

REZULTATET

Nigeria-Islandë 2-0
Brazil-Kosta Rikën 2-0

Sot takohen:
14:00 Belgjika-Tunizia
17:00 Koreja e Jugut-Meksika
20:00 Gjermania-Suedia

Gashi: Stadiumi në Kamenicë do të përfundojë sivjet



PRISHTINË, 22 QERSHOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi dhe kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, kanë nënshkruar të premten një Memorandum për Stadiumin e Qytetit në vlerë prej 100 mijë eurosh. Pas nënshkrimit të këtij memorandumi, Gashi dhe Kastrati e kanë vizituar stadiumin e qytetit për t'i parë nga afër

punimet që po zhvillohen. Ministri Gashi ka premtuar se ministria që ai e drejton do t'i mbështesë projektet e kësaj komune. "Është kënaqësi e veçantë ta jap mesazhin për qytetarët e Kamenicës, për përkushtimin tonë si ministri për të realizuar projekte kapitale. Një projekt që ka filluar 14 vjet me parë, ai i palestrës sportive të Kamenicës, do të përfundojë

këtë vit. Gjatë këtij viti do të intervenojmë dhe të përfundojmë këtë projekt. MKRS-ja ka planifikuar 100 mijë euro për këtë vit dhe me këtë shumë do ta përmbyllim fazën finale të këtij projekti", ka thënë ministri Gashi. Ndërsa i pari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka falënderuar ministrin për mbështetjen që po ia jep Komunës së Kamenicës.

Sot në "Tarragona 2018" përballen Luzhnica dhe Asllani

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Ekipi i shigjetarisë ka përfunduar garën kualifikuese për renditje më të mirë në disiplinën hark olimpik të Lojërave Mesdhetare "Tarragona 2018". Pas rezultateve të ditës së premte, sot (e shtunë) do ta kemi përballjen e dy garuesve nga Kosova, Atdhe

Luzhnica dhe Hazir Asllani, të cilët do të sfidohen në 1/24 e finales. Në garat kualifikuese Atdhe Luzhnica pati rezultatin më të mirë, duke u renditur në vendin e 31 nga 40 garues. Luzhnica mbledhi 570 pikë nga të dy seritë. Shigjetari tjetër, Hazir Asllani, u rendit tri pozita

më poshtë (34), me 549 pikë. Në bazë të këtyre pozitive, shorti deshi që të kemi një përballje kosovare. Në konkurrencën e femrave, Ardita Zejnullahu doli e 21-ta (494 pikë) nga 24 garuese. Ajo në 1/16-ën e finales takohet me slovenen Ana Umer. Garat e sotme fillon nga ora 9:30.



Raikkoneni afër pensionit, Ferrari mendon për Ricciardon

ESPOO, 22 QERSHOR - Kimi Raikkoneni mund të largohet nga Ferrari në fund të këtij sezoni. Finlandezi, 39-vjeçar, po mendon për t'u tërhequr nga ky sport, ndërkohë që pesë sezonet e

fundit i ka kaluar me makinën italiane. Te Ferrari e kanë pritur një gjë të tillë dhe kanë gati zëvendësuesin. Ai është Charles Leclerc, një pilot 21-vjeçar, që vjen nga Akademia

Ferrari, që aktualisht piloton makinën Sauber-Alfa Romeo. Duket se paraqitjet e fundit nuk e bindin pilotin veteran të garave të Formula 1, aktualisht i pesti në renditjen botërore. Me Ferrarin,

Kimi Raikkonen ka fituar një titull kampion në vitin 2007. Në garë për një vend të "kokëkuqja" është edhe australiani Daniel Ricciardo, një pilot me më shumë përvojë në këtë sport.

Aliu premtion mbështetje të sportistëve në gara ndërkombëtare

FERIZAJ, 22 QERSHOR - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka pritur në takim ferizajasin Aldon Sadiku, i shpallur nënkampion në kategorinë "classic bodybuilding" në Kampionatin Ballkanik të mbajtur në Rumani prej 18-20 majit të këtij viti, pjesëmarrës të së cilës ishin nga të gjitha shtetet e Ballkanit. Nënkampioni Sadiku ka falënderuar kryetarin e komunës, Agim Aliun, për pritjen dhe mbështetjen që po i jep në vazhdimësi sportit dhe të rinjve të dëshmuar me suksese në arenën vendore dhe ndërkombëtare.

Edhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka njoftuar në detaje gjendjen në sportin ferizajas dhe investimet që priten të realizohen së shpejti. Në këtë kuadër ai ka garantuar mbështetjen e sportistëve në pjesëmarrjen e tyre në gara ndërkombëtare, duke theksuar se këto suksese nuk janë vetëm individuale, por të rëndësishme edhe për qytetin tonë, duke e promovuar atë jashtë kufijve shtetërorë.



Williamsi, në dyshim për Wimbledonin

WASHINGTON, 22 QERSHOR - Serena Williamsi, e tërhequr në raundin e katërt të grand slemit të Roland Garros, mund të mos luajë në grand slem-in e Wimbledonit, që nis më 2 korrik në Londër. Lajmin e ka konfirmuar trajneri i saj Patrick Mouratoglou, i cili ka thënë se ish-numri 1 në botë po bën maksimumin e saj për të qenë në turneun e fushave me bar. "Është një dëmtim muskolor dhe bëme mirë që nuk e lejuam të luajë e dëmtuar në Roland Garros, pasi mund të kishte kaluar në një problem serioz", ka thënë trajneri Mouratoglou. "Serena duhet të jetë shëruar brenda qershorit dhe të jetë në gjendje të luajë sërish, por kjo mbetet ende një hipotezë. Ajo do të vijë në Londër pesë ditë para fillimit të turneut, ku do ta



testojë veten dhe më pas do të vendosim. Serena është e paparashikueshme, ndaj çdo gjë do të jetë në dyshim, pasi duhet të zhvillojmë edhe disa seanca stërvitore në fushat me bar për t'iu përshtatur kësaj sipërfaqe", u shpreh trajneri i tenistes amerikane.

SHKURT

Ajdareviçi vizitoi Prishtinën

Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë dhe i kampionëve të Greqisë, AEK nga Athina, Astrit Ajdareviç, të premtion e ka vizituar skuadrën e Prishtinës. 28-vjeçari i lindur në Prishtinë e ka uruar skuadrën "bardhekaltër" që të përfaqësojë sa më mirë Kosovën në ndeshjet e UEFA Evropë Ligës.

Van Bommel, trajner i PSV-së

Ish-ylli i Holandës, Mark Van Bommel, është emëruar trajner i ri i skuadrës së PSV-së. Van Bommeli e zëvendëson Philip Cocun në stolin e skuadrës holandeze, kurse ka nënshkruar kontratë trevjeçare me gjigantët holandezë. Van Bommel në karrierën e tij të pasur futbollistike ka luajtur për Fortuna Sittard, PSV, Barcelona, Bayern Munchen dhe Milan.

Emery kërkon Banegan në Arsenal

Ever Banega është i gatshëm t'i bashkohet Arsenalit, por së pari dëshiron siguri për rolin e tij në skuadrën e Unai Emery. Ka qenë vetë tekniku i "Topçinjtë" ai i cili ka kërkuar që argentinasi të transferohet në "Emirates", pasi ka punuar me 29-vjeçarin gjatë kohës që ka drejtuar Valencian dhe Sevillan. Me emërimin e Emeryt në krye të Arsenalit, Banega është një nga emrat më të lakuar për t'u transferuar në Londër.

Payton zgjedhja e parë e draftit shkon te Phoenixi

Në "Barclays Center" në Brooklyn u vu në skenë drafti i vitit 2018 në NBA. Skuadrat e basketbollit amerikan zgjedhën talentet më të mira. Zgjedhja e parë i takonte skuadrës më të dobët të këtij sezoni, Phoenix Suns, me ekipin nga Arizona që mori 19-vjeçarin DeAndre Payton nga Universiteti i Arizonas me këtë të fundit që u bë kështu zgjedhja e parë e draftit për vitin 2018. Te Sacramento Kings shkoi Marvin Bagley 3, i cili ishte zgjedhja e dytë. Shkëmbim mes Atlanta Hawksit dhe Dallas Mavericksit. Skuadra nga Georgia ka zgjedhur filimisht Luka Donciq për ta xhiruar atë më pas te tek-sanët e Dallasit duke marrë në shkëmbim zgjedhjen e pestë, Trae Young.

Nagelsmanni, trajner i Leipzigit

Leipzigit ka arritur marrëveshje me trajnerin Julian Nagelsmann. Ky i fundit do ta marrë drejtimin e skuadrës së re pas përfundimit të sezonit 2018/19. "Julian Nagelsmann do të largohet nga TSG-ja në fund të sezonit 2018/19. Trajneri 30-vjeçar e ka udhëhequr Hoffenheimin që nga viti 2015", thuhet në njoftimin e klubit gjerman.

Lojtarët duan largimin e Sampaolit

Ekipi vendos në qendër të kritikave trajnerin Sampaoli. Ky i fundit ka marrë përgjegjësitë e humbjes por, mesa duket, nuk mjafton. Zgjedhjet e gabuara në formacion në të dyja ndeshjet mund ta largojnë atë nga stoli i Argjentinës dhe në ndeshjen me Nigerinë në stol të jetë një trajner tjetër. Emri që përflitet është Jorge Buruçaga, kampion bote në vitin 1986. Lojtarët janë rebeluar kundër Sampaolit dhe duket se ata nuk do t'i binden më. Federatës Argjentinase të Futbollit mund t'i kushtojë shumë shkarkimi i tij, përflitet një shumë deri në 20 milionë dollarë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Prishtinë, 23.06.2018

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L – 149 neni 12.4 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, shpall:

KONKURS Për Marrëveshje me Shërbime të Veçanta

Titulli i punës: Zhvillues i programeve - ekspert për teknologjinë informative

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Niveli pagës: 1.000.00 (një mijë) euro

Kohëzgjatja e emërimit: 6 (gjashtë) muaj

Orët e punës: I pjesshëm

Raporton: Udhëheqësi Ekzekutiv

Vendi i punës: Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 Prishtinë

- Identifikon, analizon, dhe vlerëson gjendjen në sistemin e Teknologjisë Informative (TI) të KKTK, njëkohësisht propozon, këshillon dhe rekomandon Udhëheqësin Ekzekutiv lidhur me nevojat e funksionimit dhe të zhvillimit të sektorit të TI të KKTK-së, me qëllim të avancimit dhe të sigurimit afatgjatë të sistemit të TI sipas kushteve dhe standardeve më të larta të sigurisë;
- Zhvillon web faqen e KKTK-së, sipas kërkesave dhe nevojave të institucionit;
- Zhvillon web aplikacionet e nevojshëm, rekomandon aplikacionet dhe platformat softwerike të rëndësishme për KKTK-në, me qëllim të përmbushjes së nevojave të KKTK-së;
- Krijon bazën e të dhënave të KKTK-së, dhe bën sigurimin e integritetit dhe sigurisë së të dhënave në databazë;
- Bën administrimin dhe intervenimin softwerike për funksionalizimin dhe ri-funksionalizimin e web faqes dhe web aplikimit;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale, të delaguara nga mbikëqyrësi .
- Trajnimi i stafit i cili do të administroj, mirëmbajë (rifreskoi) ueb faqen dhe web aplikacionet.
- Përgaditja e manualeve të aplikacioneve ku duhet të sqarohet në mënyrë sa më të thjeshtë mënyrën e punës së përdoruesve që do ta përdorin aplikacionet.

Shkathësitë e kërkuara (Kualifikimi, përvoja si dhe aftësitë dhe shkathësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës):

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike, të fituar përmes arsimimit universitar ose edhe trajnimeve përkatëse;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe në formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale për fushën e TIK-ut;
- Diplomë universitare në shkencat kompjuterike dhe drejtimit tjera adekuate;
- Certifikata në MCSD edhe të tjera;
- Së paku 3 (tri) vjet përvojë në zhvillimin , mirëmbajtja e web platformave të natyrës së njëjtë të punës së institucionit;
- Njohuri për zhvillimin e web service (API), web compeonets, paraqitje të ndryshme teknike të të dhënave në web platform;
- Njohuri për konceptet e sigurisë së të dhënave dhe aplikimit të metodave për sigurinë e informacionit.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 kati i II (dytë) zyra nr.206, Prishtinë, Kosovë ose në form elektronike: <http://kktk.rks-gov.net>. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni Tel: +381 (0) 38 211 617, prej orës 08:00-16:00. Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të marrin në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontakohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Prishtina, 23.06.2018

Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo br. 03/L – 149 član 12.4 i Uredbe br. 02/2011 o proceduri regrutiranja u civilnoj službi Republike Kosovo, Savet Kosova za Kulturno Nasledje, objavljuje:

KONKURS za Ugovor za posebne usluge

Naziv radnog mesta: Programer - stručnjak za informacionu tehnologiju

Vrsta ugovora: Ugovor za posebne usluge

Nivo plate: 1.000,00 (hiljadu) cvra

Trajanje imenovanja: 6 (šest) mjeseci

Radno vreme: delimično

Izveštava: Izvršnom rukovodiocu

Radno mesto: Kompleks Rilindja, kontejner br. 3 Priština

- Identifikuje, analizira i ocenjuje stanje sistema Informacione Tehnologije (IT) SKKN-a, istovremeno predlaže, savetuje i preporučuje izvršnom rukovodiocu u vezi sa potrebama funkcionisanja i razvoja IT sektora SKKN-a, sa ciljem unapređenja i dugoročne sigurnosti IT sistema u skladu sa najvišim sigurnosnim zahtevima i standardima;
- Razvija web stranicu SKKN-a, u skladu sa zahtevima i potrebama institucije;
- Razvija neophodne web aplikacije, preporučuje aplikacije i softverske platforme važne za SKKN, sa ciljem zadovoljavanja potreba SKKN-a;
- Kreira bazu podataka SKKN i obezbeđuje integritet i sigurnost podataka u bazi podataka;
- Vršiti upravljanje i softversku intervenciju za funkcionalizaciju i re-funkcionalizaciju web stranice i web aplikacije;
- Izvršava bilo koji drugi zadatak u specifičnoj profesionalnoj oblasti u skladu sa važećim zakonima i uredbama, delegiran od strane nadzornika.
- Obučava osoblje koje će upravljati, održavati (osvežavati) web stranicu i web aplikacije.
- Priprema priručnike za aplikacije u kojima je potrebno što jednostavnije objasniti način rada korisnika koji će koristiti aplikacije.

Potrebne veštine (kvalifikacija, iskustvo, kao i druge sposobnosti i veštine potrebne za ovo radno mesto):

- Detaljno i specijalizovano znanje iz specifične stručne oblasti, stečeno univerzitetskim obrazovanjem ili odgovarajućom obukom;
- Istraživačke, analitičke, i veštine procene i formulisanja preporuka i profesionalnih saveta u oblasti ITK-a;
- Univerzitetska diploma iz računarstva i drugih odgovarajućih smerova;
- Sertifikat u MCSD i drugi;
- Najmanje 3 (tri) godine iskustva u razvoju, održavanju web platformi iste prirode posla institucije;
- Poznavanje razvoja web service (API), web compeonets, različitih tehničkih prezentacija podataka na web platformi;
- Poznavanje konceptata sigurnosti podataka i primene metoda sigurnosti informacija.

Prijem i podnošenje aplikacija

Savet Kosova za Kulturno Nasledje, Kompleks Rilindja, kontejner br. 3, II (drugi) sprat, kancelarija br. 206, Priština, Kosovo ili u elektronskoj formi: <http://kktk.rks-gov.net>. Za detaljnije informacije možete kontaktirati na Tel: +381 (0) 38 211 617, od 08:00-16:00 časova. Konkurs je otvoren 8 dana od dana objavljivanja u jednom od dnevnih novina.

Aplikacije poslate poštom, koje nose poštanski žig na pošiljci poslednjeg dana roka za apliciranje, će se smatrati validnim i uzeće se u obzir ako stignu u roku od 4 četiri dana, aplikacije koje stignu nakon ovog roka, i one nepotpune uopšte neće biti razmatrane.

Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i očekuje aplikacije svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu.

Aplikacije dostavljene nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune aplikacije će biti odbijene. Aplikaciji priložite kopije dokumentacije o kvalifikaciji i drugu neophodnu dokumentaciju potrebnu za radno mesto za koje konkurirate. Biće kontaktirani samo kandidati odabrani u uži izbor.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Prishtinë, 23.06.2018

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L – 149 neni 12.4 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, shpall:

KONKURS për Marrëveshje me Shërbime të Veçanta

Titulli i punës : Zyrtar për Trashëgimi Kulturore

Koeficienti: 7

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Kohëzgjatja e emërimit: 6 (gjashtë) muaj

Orët e punës: 40 orë në javë

Raporton: Udhëheqësi Ekzekutiv

Vendi i punës: Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Pranon aplikacionet e propozuara mbi shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme;
2. Analizon dhe shqyrton në përputhje me procedurat e përcaktuara, parimet, kriteret dhe rregullat në fuqi;
3. Përgatit raportin me rekomandime për shpallje ose refuzim të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme;
4. Identifikon pengesat dhe problemet, analizon, dhe raporton për gjendjen e trashëgimisë kulturore, duke propozuar masat shitesë për ruajtje dhe mbrojtje.
5. Në bashkëpunim me udhëheqësin koordinon përgatitjen e programit për vetëdijesim publik, për nxitjen e arsimit, ngritjen e vetëdijes, partneritetit dhe bashkëpunimit në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
6. Ofron këshilla në fushën e ekspertizës së kërkuar brenda institucionit;
7. Përgatit raporte periodike mbi aktivitetet organizative dhe çështjeve që kërkojnë shqyrtim nga Udhëheqësi Ekzekutiv;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Shkathtësit e kërkuar:

- Diplomë universitare në: trashëgimi kulturore, histori, arkeologji.
- Njohuri në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me trashëgimi kulturore;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Aftësi për përmbyshje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit)

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 kati i II (dytë) zyra nr.206, Prishtinë, Kosovë ose në form elektronike: <http://kktk.rks-gov.net>. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni Tel: +381 (0) 38 211 617, prej orës 08:00-16:00. Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkojnë për atë vend pune për të cilin konkurren. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Priština, 23.06.2018

Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo br. 03/L – 149 član 12.4 i Uredbe br. 02/2011 o proceduri regrutiranja u civilnoj službi Republike Kosovo, Savet Kosova za Kulturno Nasledje, objavljuje:

KONKURS za Ugovor za posebne usluge

Naziv radnog mesta: Službenik za kulturno nasleđe

Koeficijent: 7

Vrsta ugovora: Ugovor za posebne usluge

Trajanje imenovanja: 6 (šest) meseci

Radno vreme: 40 časova nedeljno

Izveštava: Izvršnom rukovodiocu

Radno mesto: Kompleks Rilindja, kontejner br. 3 Priština

Dužnosti i odgovornosti:

1. Prima predložene aplikacije o proglašavanju kulturnog nasleđa pod trajnom zaštitom;
2. Analizira i razmatra u skladu sa utvrđenim procedurama, načelima, kriterijumima i pravilima na snazi;
3. Priprema izveštaj sa preporukama za proglašavanje ili odbijanje kulturnog nasleđa pod trajnom zaštitom;
4. Identifikuju prepreke i probleme, analizira i izveštava o stanju kulturnog nasleđa, predlažući dodatne mere za očuvanje i zaštitu.
5. U saradnji sa rukovodiocem koordinira pripremu programa za podizanje javne svesti, za podsticanje obrazovanja, podizanja svesti, partnerstva i saradnje u zaštiti kulturnog nasleđa;
6. Pruža savete u oblasti ekspertize koja se traži unutar institucije;
7. Priprema periodične izveštaje o organizacionim aktivnostima i pitanjima koja zahtevaju razmatranje od strane Izvršnog rukovodioca;
8. Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonima i uredbama koji se mogu zahtevati u razumnom roku s vremena na vreme od strane nadređenog.

Potrebne veštine:

- Univerzitetska diploma iz: kulturnog nasleđa, istorije, arheologije.
- Znanje iz oblasti kulturnog nasleđa;
- Poznavanje važećih zakona i uredbi koji se odnose na kulturno nasleđe;
- Veštine komunikacije, planiranja posla;
- Sposobnost obavljanja dužnosti i poslova pod pritiskom;
- Veštine rada na računaru sa aplikacijama/programima (Word, Excel, Power Point, Internet)

Prijem i podnošenje aplikacija

Savet Kosova za Kulturno Nasleđe, Kompleks Rilindja, kontejner br. 3, II (drugi) sprat, kancelarija br. 206, Priština, Kosovo ili u elektronskoj formi: <http://kktk.rks-gov.net>. Za detaljnije informacije možete kontaktirati na Tel: +381 (0) 38 211 617, od 08:00-16:00 časova. Konkurs je otvoren 8 dana od dana objavljivanja u jednom od dnevnih novina.

Aplikacije poslate poštom, koje nose poštanski žig na pošiljci poslednjeg dana roka za apliciranje, će se smatrati validnim i uzeće se u obzir ako stignu u roku od 4 četiri dana, aplikacije koje stignu nakon ovog roka, i one nepotpune uopšte neće biti razmatrane.

Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i očekuje aplikacije svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu.

Aplikacije dostavljene nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune aplikacije će biti odbijene. Aplikaciji priložiti kopije dokumentacije o kvalifikaciji i drugu neophodnu dokumentaciju potrebnu za radno mesto za koje konkurišete. Biće kontaktirani samo kandidati odabrani u užu izbor.



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 KUVENDI KOMUNAL –MALISHEVË
 QKMF "Dr.SHPËTIM ROBAJ" në Malishevë
 Nr.Prot. 204/18
 Datë .22.06.2018



Drejtori i QKMF-së "Dr.Shpëtim Robaj" në Malishevë, në bazë të Rekmandimit nr.07/98 dt.20.06.2018 të drejtorit të Shëndetësisë dhe MS në Malishevë ,nenit 8 të ligjit të punës nr.03/L-212 si dhe nenit 4 të udhimit administrative nr.7/2017, për rregullimin e procedurave për konkurs në sektorin public; për plotsimin e vendeve të punës publikon këtë:

KONKURS

Për pranimit të:

I. 6. (gjashtë) Mjek të praksës së përgjithshme në kohë të pacaktuar:

Detyrat e punës:

Ofron shërbime shëndetësore nga kujdesi primar shëndetësor në QKMF, QMF dhe AMF. Siguron kujdes primar shëndetësor për të gjithë qytetaret pa dallim:kombi, etnie, feje, race. Gjinnie, Shkruan terapinë, në bazë të diagnostifikimit, udhëzon pacientët në qendra tjera spitalore, kryen të gjitha punët tjera të mjekut familjar në bazë të ligjit të shëndetësisë. bashkëpunon me mjekë tjerë, për punën e vetë i përgjigjet shefit të mjekësisë familjare , dhe drejtorit të QKMF-së.

II. 1.(një) Laborant i lartë Mjekësorë në kohë të pacaktuar.

Detyrat e punës:

Kryen analiza laboratorike sipas udhëzimeve të mjekëve ,i evidenton në librin protokollit, Kryen të gjitha punët laboratorike të cilat parashihen me ligjin e shëndetësisë dhe me aktet normative të QKMF-së. Për punën e tij i përgjigjet ,shefit të laboratorit dhe drejtorit të QKMF-së.

Kushtet e konkursit:

- Për Mjek:Diploma e fakultetit të mjekësisë drejtimi i përgjithshëm,
- Për Laborant:Diploma Laborant i lartë Mjekësorë. Ndërsa kushtet e përgjithshme:
- Licencën e punës,
- Certifikatën e lindjes,
- Certifikatën që nuk është nën hetime ose i denuar.
- Certifikatën e mjekut për punë.
- Leternjohtimin të fotokopjuar.

-Kohëzgjatja kontratës: në kohë të pacaktuar (pas përiudhës provuese tremujore).
 -Orët javore të punës 40.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjete të informimit, aplikacionet e arritura pas afatit nuk pranohen, aplikacionet me dokumenta të pa kompletuara nuk shqyrtohen. dokumentacioni dorëzohet në zyrën e personelit të QKMF-së.

Drejtori
 Dr.Nuhi Morina sp.Pediater

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » G.S.M Net « SH.P.K., me seli në Prizren, rruga: ADEM JASHARI, PN., ka marrë vendim që ta shuaj biznesin - Shoqërinë me NRB. dhe NRF.810083709 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e prodecurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

O B A V E Š T E N J E

Obavještavamo sve kliente da društvo » G.S.M Net « D.o.o.,sa sedištem u Prizrenu, ulica: ADEM JASHARI, bb., doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 810083709 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the company "G.S.M Net" LLC, based in Prizren, the road: ADEM JASHARI, PN, has taken the decision to cancel the business - the company with NRB. and NRF.810083709 with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
 GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
 OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

GJYKATA THEMELORE
 C.nr.166/2015
 Me dt.21.06.2018
 Mitrovicë

„GAZETA ZYRTARE „ E REPUBLIKES SE KOSOVES

PRISHTINË

Në bazë të nenit 83 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të Kosovës kërkujmë të publikoni këtë,

SH P A L L J E

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në qështjen juridike të paditësit: Haxhi Nimanaj nga Mitrovica , kundër të paditurit: Dragoljub Stojiq nga Mitrovica, tani me vendbanim te panjohur baza e kontestit : Vertetim pronësie ,ne baze te nenit 79.pika 3-a e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore te Kosoves te paditurit: Dragoljub Stojiq i caktohet perfaqesuesi I perkoheshem Xhelal Hasani avokat ne Mitrovicë .

Përfaqësuesi i perkohshmem do ti përfaqësoi të paditurin në këtë çështje juridike deri sa ai apo i autorizuari i tij të paraqiten në këtë gjykatë.

GJYQTARI,
 Ragip Kadriu

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sofie Zeka shpall të pavlefshme dëftesat e Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë të lëshuar në vitin 1994.

► Molos Sylja shpall të pavlefshme dëftesat e klasës -X- dhe -XI- të Gjinnazit "Sami Frashëri", drejtimi i Shkencave Natyrore, Prishtinë.

► Fatjona Qovanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "Leke Dukagjini" Prizren.

► Kushtrim Ademqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Avdyl Frashëri" Prizren.

► Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllëshi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Trullin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truallit frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lfti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxejje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Trullin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truallit frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Për informata më të marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333